**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

# RAPORT

**I PUNËS SË KRYETARIT & ORGANEVE EKZEKUTIVE,**
**për vitin 2019 me Planet e Punës, vitin 2020**

**Kryetari: Shaban Shabani**

**Dragash,________2020**

# RAPORT

## I PUNËS SË KRYETARIT & ORGANEVE EKZEKUTIVE TË KOMUNËS SË DRAGASHIT, për vitin 2019 me PLANET E PUNËS, për vitin 2020

Edhe gjatë vitit kalendarik/2019, puna e kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit, është zhvilluar përmes 8 drejtorateve dhe shërbimeve përcjellëse komunale, në harmoni me dispozitat ligjore e konform Ligjit për Vetëqeversije Lokale, udhëzimeve administrative dhe Statutit të Komunës, duke u vepruar sipas nevojave qytetare dhe zbatimit të dispozitave ligjore me kompetenca të plotab nga fushëveprimtaria e Komunës. Në këtë kontekst, konsiderohet se organet ekzekutive janë munduar që të janë sa më azhure në respektimin e afateve ndaj kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve më të larta shtetërore dhe të shoqërisë civile, si dhe prezantimin e dokumenteve të nevojshme përgatitore për në Kuvend, ku janë shqyrtuar dhe miratuar, zyrtarisht, aktet komunale. Për këtë qëllim, qytetarëve u janë ofruar shërbime në nxjerrjen e dokumenteve personale, dokumenteve për regjistrim të bizneseve e automjeteve, dokumente kadastrale dhe shumë dokumente të tjera në realizimin e të drejtave si qytetarë të Komunës, si dhe kërkesa të instancave komunale, për ministritë tona dhe ndaj institucioneve ndërkombëtare. Kërkesat e qytetarëve dhe dokumentet e lëshuara, në emër të Komunës , sipas drejtorateve përkatëse, konkretisht e numerikisht, janë të përfshira në raportet e 8 drejtorateve komunale-veq e veq. Këto dokumente të organeve komunale bazën e veprimit e kishin në kompetencat e deleguara ligjore komunave, që, si të tilla, janë përfillur edhe nga zyrtarët tonë komunal dhe, lirisht, mund të thuhet se, në këtë drejtim, nuk ka pasur ankesa dhe vërejtje të theksuara të qytetarëve, të institucioneve, të ministrive tona, apo OJQ-ve të shoqërisë civile të cilat monitorojnë punën tonë të përditshme e të kohëpaskohshme, duke marr pjesë në takimet tona të hapura, si dhe përmes kërkesave për qasje në dokumente zyrtare. Megjithkëtë, krahas punëve të kryera, nga viti i shkuar kalendarik-2019, për vitin vijues-2020 ngel obligimi permanent. i organeve tona që të janë edhe më azhure, si në ofrimin e shërbimeve sa më efikase qytetarëve, po ashtu edhe në përcjelljen e ligjshmërisë, përmes hartimit të propozim-rregulloreve e vendimeve të reja që i kërkojnë ligjet dhe momenti, sipas nevojat reale, përmes aplikmit të dispozitave të reja pozitive në praktikën e përditshme, për të mirën e qytetarëve tonë. Në kontaktet e posaçme me secilin drejtor të drejtoratit apo zyrtar përgjegjës komunal, sikurse edhe me takime të Bordit të Drejtorëve është analizuar mbarvajtja e punëve të përditshme në secilin sektor të Komunës, duke u propozuar masa dhe ndërmarr qëndrime për mbarvajtjen e punëve për evitimin e dobësive

eventuale-ditore , që janë theksuar nëpër takime zyrtare dhe nga qytetarët që u janë drejtuar kryetarit dhe organeve kompetente komunale.

Prandaj, pos punëve të përditshme zyrtare, nëpër organe komunale, zyrat e Komunës, si: Zyra e Kryetarit e nënkryetarëve të Komunës, Kryesuesit të KK-së, drejtorëve të drejtorateve dhe zyrtarëve tjerë komunal kanë qenë gjithnjë të hapura për qytetarë dhe subjekte vendore e ndërkombëtare, parti politike, OSCE-në, KFOR-in, FSK-në, Policinë e Kosovës, OVL të UÇK-së, përfaqësues të ministrive tona, të OJQ-ve vendore e ndërkombëtare, gazetarë, grupe qytetarësh e delegacione të lokaliteve tona, që i kanë shprehur brengat dhe kërkesat e tyre. Në këto kontakte pune, sidomos ato me përfaqësues të lartë ndërkombëtar dhe të ministrive tona, zakonisht, vinin në shprehje iniciativat, kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të lokaliteteve tona dhe të Komunës me qëllim të realizimi të projekt-programeve zhvillimore (siç kemi rastin me iniciatrivat dhe projektet e realizuara përmes: UNDP-së, ADA, USAID-in, Caritas-in e Helvetas-in Zvicrran, BE-së, OSCE-së etj). Të mirëseardhura kanë qenë edhe shkëmbimet e përvojave reth çështjeve të sigurisë (me KFOR-in, Policinë, FSK-në), nevoja e funksionimit më të mirë të lëmive të ndryshme jetësore dhe sfidat që paraqiten lidhur me nevojën e zhvillimit të Komunës, efikasitetet të shërbimeve, si dhe iniciativat e ndryshme për interesin e përgjithshëm të Komunës dhe qytetarëve tonë, në përgjithësi. Në këtë kontekst, si fryt i bashkëpunimit me subjektet e shumëta vendore e ndërkombëtare, gjatë periudhës raportuese, është realizuar asfaltimi dhe kubëzimi i pothuaj të gjithëve rrugëve kryesore rajonale e lokale, investime në objekte shkollore e shëndetësore e që janë në funksion të nevojave të nxënësve e pacientëve, si dhe janë vu kontakte për bashkëpunim sa më të mirë ndërkufitar me komuna të shteteve fqinje-Shqipërisë e Maqedonisë. Ritmi i punës së përditshme, gjatë vitit 2019 kontribuoi që të përmbyllen me sukses të 181 tenderëve publik, që, përmes procedurës përkatëse tenderuese, iu besuan kompanive që operuan te ne, duke ardhur në shprehje obligimi ligjor i çmimit më të ultë, në shumë të përgjithsme prej afro 2.069.841,oo eurove, qoft me mjete vetanake apo nga grantet qeveritare dhe donatorët vendor e ndërkombëtar, edhe pse një numër i mjeteve (përfshi edhe ujësjellësin qendror prej afro 500 mijë eurove) ngelën pa u realizuar për shkaqe objektive e jo për faj të organeve komunale. Në anën tjetër, përmes miratimit të Buxhetit Komunal, për vitin vijues-2020, në shumë prej 9.045.191,oo eurove, parashihet realizimi i 82 projekteve investuese kapitale në vlerën 2.550.430,oo milionë euro, që supozohet se janë orjentuar, në mënyrë reciproke, sepse, edhe sipas kërkesave të tyre, janë përfshirë të gjitha lokalitetet e komunës sonë, ashtu siç ka vendosur, në mënyrë transparente dhe sipas diskutimeve publike-Kuvendi Komunal, dhe siç janë janë paraparë e publikuar edhe në web-faqen e Komunës sonë, si reth hapjeve po ashtu edhe me dhënien e tyre operatorëve fitues të tyre.

Gjatë vitit të shkuar kalendarik, me qëllim të ofrimit sa më efikase të shërbimeve nd qytetarëve, ka qenë e domosdoshme që, nëpër organe komunale, të bëhet freskimi me paisje teknil për punë më efikase me palë, është kompletuar dhe trajnuar stafi civil për aplikimin në punë programeve të reja dhe përdorimin e paisjeve të teknologjisë informative, freskimi dhe azhurimi web-faqes me dokumente të organeve zyrtare, irformata komunale etj.,që janë edhe detyra obligues vijuese për të ardhmen, që faqja zyrtare-komunale, vërtetë, të jetë "dritare" e Komunës, për qytetar tonë dhe mbar opinionin e gjerë i cili interesohet për qaasje në dokumentet zyrtare.

Periudha raportuese ishte vazhdimi i praktikës së vizitave pune të kryetarëve të komunave i Kosovës dhe komunës sonë, apo zyrtarëve tjerë komunal (përfshi edhe delegatët dhe stafin Kuvendit) -, jasht vendit, sidomos në vendet fqinje - të rajonit: Maqedoni, Shqipëri, Turqi, Austr Gjermani dhe në disa vende të BE-së, vizita këto që shërbenin si rast i mirë i shkëmbimit të përvojav në aspektin e shtimit të efikasitetit të shërbimeve komunale për qytetarët dhe njohje me të arritur zhvillimore dhe qeverisëse, si dhe vurja e kontakteve për bashkëpunim reciprok me pushtetet lokal të atyre vendeve, që do të shërbejnë si udhërrëfim për qeverisje sa më të mirë dhe investime më t vrullshme në të ardhmen për komunën tonë, me projekte të reja investuese që i kontribuojnë t ardhmes.

Për pushtetin lokal ishte dhe ngel sfidë shfrytëzimi i pa mjaftueshëm i resurseve natyror përmes implementimit të Planit Zhvillimor e të Planit të Biodiversitetit në Komunën tonë, si dh shfrytëzimi i mundësive për energji të ripërtritshme me realizimin e projekteve të parapara pë hidocentrale të vogëla në terrenet e komunës sonë, për çka Kuvendi ka dhënë përkrahje dhe ësht shprehur interesimi nga investitorët dhe priten aktivitete formale të tyre reth kompletimit t dokumentacionit, shpronësimit të pronës dhe fillimit të investimeve dhe për shtimin e furnizimit s më adekuat me energji elektrike (sidomos të komunës sonë), por edhe më gjerë - në mbar Kosovën.

Sipas kompetencave të tyre, organet e Komunës dhe vetë Kuvendi Komunal, si organ më lartë legjislativ, kanë dhënë pëlqime të ndryshme nga të cilat priten investues të rinjë, që do t përkrahen në bizneset e tyre edhe përmes privatizimeve të parapara nga AKP-ja për shfrytëzin racional të pasurisë natyrore, siç janë ujërat apo kullotat tona, që do të kontribuonin në nxitjen e blegtorisë e bujqësisë te ne, për të cilën lëmi kemi kushte optimale e që ende nuk janë shfrytëzuar s duhet e kështu do të evitoheshin edhe keqpërdorimet në shfrytëzimin e tyre.

Lidhur me çështjet e sigurisë së qytetarëve, gjatë periudhës raportuese, kan vazhduar trende stabile, nga se komuna e jonë nuk ka pasur probleme të theksuara dhe, nga institucionet vendore e ndërkombëtare, çmohemi si mjedis me situatë më stabile politike e të sigursë, me mardhënie të mira ndëretnike e lëvizje të lirë të qytetarëve tonë, ndërsa me rastet që kanë qenë të evidentuara si prishje e

rendit dhe qetësisë publike janë preokupuar organet kompetente, si : Policia e Kosovës dhe organet e drejtësisë, që kanë qenë plotësisht të pavarura në ushtrimin e komptencave të tyre ligjore. Nga Komuna është bërë shënimi i datave tona të rëndësishme, si: Dita e Pavarësisë, Dita e Dëshmorëve, Dita e Çlirimit të Komunës, Dita e Flamurit dhe festat e manifestimet tjera komunale e shtetërore të karakterit masovik, organizimet kulturore-sportive, nuk kanë kaluar pa u implikuar dhe mbështetur nga institucionet e pushtetit lokal, sepse paraqesin praktikë tadicionale që aplikohen dhe, si të tilla, janë mbështetur edhe materialisht nga buxheti i Komunës dhe donatorët e siguruar.

Detyrë permanente për Komunën ka qenë dhe mbetet zbutja e problemeve sociale, nga se kërkesat për ndihëma janë në rritje e mundësitë buxherore për këtë kategori janë të redukura, ndërsa edhe kriteret e përfitimit të tyre janë gjithnjë e më ashpëra nga MPMSociale, gjë që, me shumë vështirësi, po ka mundësi t'u delet në ndihmë të gjithë nevojtarëve, qoft edhe me subvencione, që do të shtohen nga viti në vit, kurse vjet (me bartje të mjeteve të mbetura, nga viti 2018) ato ishin 741 mijë euro. Në këtë aspekt, përkrahje formale dhe lehtësime fillestare, ofroi edhe Rregullorja mbi Taksat Komunale që i'u dha mundësia bizneseve ekzistuese dhe afaristëve të rinjë të kontribuojnë në rimëkëbje afariste dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Për vitin e shkuar, sado-pak lehtësuese për qytetarët shkoi ishte edhe miratimi i Vendimit të Kuvendit për kompenzimin e shpenëzimeve të varrimit, në mënyrë lineare, me nga 100,oo euro për 238 raste në shumë prej 24.321,oo eurove e që, në të ardhmen, shuma do të jetë më e lartë-nga 150,oo euro për çdo rast të tillë. Në anën tjetër, ndonëse edhe deri tash ka pasur lëvizje pozitive, nuk është shfrytëzuar sa duhet nevoja e angazhimit të qytetarëve në lëmin e nxitjes së zhvillimit të bujqësisë e blegëtorisë, për të cilat fusha kemi kushte ideale natyrore te ne, lëmi këto të cilat ofrojnë perspektivë zhvillimore e të jetesës, ruajnë florën e faunën dhe biodiversitetin e Komunës, si dhe i kontribuojnë bazës ekonomike të komunës, zbutjes së problemeve sociale e të papunësisë. Në këto sfera është ofruar mundësia që, me referenca pozitive nga Komuna, të gjejnë përkrahje për realizim projekt-programet tek ministritë tona, donatorët vendor e ndërkombëtarë, bankat afariste e sidomos në Ministrinë e Bujqësisë , që ofroi subvencione e kredi të volitshme për këto lëmi profitabile të cilat i kontribuojnë zhvillimit, zbutjes së nevojave sociale dhe papunësisë.

Inkurajues është fakti se, për këtë periudhë të veprimit të institucioneve tona komunale ato kanë vepruar e funksionuar sipas Kushtetetutës dhe ligjeve të Republikës së Kosovës dhe Statutin e Komunës, për secilën lëmi përkatëse jetësore, kurse fluksi mesatar ditor i palëve te ne sillej afro 100 veta, numër ky i cili u përballua me sukses nga organet komunale, si dhe erdhi në shprehje respektimi i afateve ligjore, barazia nacionale e gjuhësore e palëve, pasi se, zyrtarisht, edhe nuk ka pasur ankesa të adresuara për mos përmbushjen e detyrave të punës nga shërbyesit civil të Komunës sonë.

**Vërejtje-Shënim:** Në vazhdim-pjesë përbërëse e këtij Raporti përmbledhës - (nën shtojcën "A") është Pasqyra e takimeve e vendimeve të organeve zyrtare Komunale, si dhe - (nën "B") raportet e drejtorateve komunale, për vitin 2019 & planet e punës, për vitin 2020...

**I ) : Shtojca:** "A"

# P A S Q Y R A

## E TAKIMEVE ZYRTARE TË ORGANEVE TË KOMUNËS ME DOKUMENTET E SHQYRTUARA E TË MIRATUARA

1. Numri i seancave të Kuvendit Komunal...............10 (të rregullta) + 1 (jashtëzak.)=11

   a) Dokumentet e miratuara:

   1/1. Numri i rregulloreve.......................................................................3
   1/2. Numri i vendimeve.......................................................................24
   1/3 Numri i pikave të rendit të ditës........................................................32

2. Numri i mbledhjeve të KPFinanca.........................................................11

3. Numri i mbledhjeve të KKomuniteteve...................................................11

4. Takimet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.................................6

5. Takimet e Bordit të Drejtorëve..........................................................5

6. Takimet publike..................................................................................2

7. Dëgjimet publike.................................................................................7

8. Takimet me kryetarë të fshatrave.........................................................2

9. Numri i vendimeve të kryetarit të Komunës(sipas LVL-e & Statutit)...................515

10. Numri i marrveshjeve,memorandumeve,pëlqimeve,referencave etj........................23

11. Kërkesa institucioneve vendore e ndërkombëtare..........................................29

12. Autorizime për gjykata,konfirmime,autorizime,urdhëresa etj...........................13

**Kryetari i Komunës-Dagash**
*Shaban Shabani*

**II ) Shtojca:** **"B "- Raportet e Punës (2019) & Planet e Punës (2020) të drejtorateve...**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

# RAPORT

**I PUNËS SË DREJTORATIT TË FINANCAVE, EKONOMISË DHE ZHVILLIMIT, për vitin 2019 & Planin e Punës, për vitin 2020**

**Drejtori: Valon Shabani**

**Dragash,________2020**

# RAPORT

## MBI PUNËN E DREJTORATIT PËR EKONOMI FINANCA DHE ZHVILLIM PËR VITIN 2019

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim , sa i përket strukturës organizative është i organizuar në këto njësi punuese:

1. Njësja punuese për Buxhet;
2. Njësia punuese per Financa
3. Njësia punuese e Tatimit në Pronë
4. Njësia punuese e Thesarit
5. Njësia punuese e Regjistrimit të Bizneseve

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim, në vitin raportues 2019, ka qenë e përqendruar në: përgatitjen e Projekt Buxhetit të komunës për vitin 2019-2021 i bazuar në Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe qarkoret buxhetore të lëshuara nga Ministria e Financave duke marre pjese ne degjime buxhetore te organizuara nga komuna dhe organizatat joqeveritare.

Punimin e raporteve të ndryshme lidhur me realizimin e buxhetit (mujore, tremujore, periodike dhe vjetrore) për asamblenë komunale , realizimin e planit të inkasimit të të hyrave vetanake nga tatimi në prone dhe të hyrave tjera vetanake, regjistrimi dhe raportimi i të hyrave vetanake në SIMFK, hartimin e rregulloreve , koordinimi i aktiviteteve të ndryshme me Ministrinë e Financave dhe Thesarin

Të gjitha këto aktivitete të lartëshenuara mbështetjen ligjore e kanë në zbatimin e drejtë të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë,

Ligjin mbi Financat e Pushtetit Lokal, Ligjin mbi Tatimin në Pronë, Udhëzimet dhe Rregulloret e ndryshme administrative.

Drejtorati per Ekonomi Financa dhe Zhvillim bazuar në dispozitat e nenit 60 dhe 61 të Ligjit Mbi Menaxhimine Fuinancave Publike dhe Përgjegjësitë si dhe qarkoreve buxhetore ka marrur pjesë në përgatitjën e Kornizës afatmesme të shpenzimeve dhe projekt buxhetin për vitin 2020-2022 për periudhën në fjalë duke i respektuar afatet dhe procedurat e aprovimit të buxhetit. Procesi i ekzekutimit të buxhetit per vitin 2019 ka filluar nga mesi i janarit të vitit 2019 sipas planit të rrjedhjes së parasë së gatshme.

Drejtorati per Ekonomi Financa dhe Zhvillim ka pergatitur planin e veprimit per rekomandimet e auditorit per pasqyrat financiare 2018

Drejtorati per ekonomi Financa dhe Zhvillim ka pergatitur -propozim rregulloren per mbi ndryshimin dhe plotësimin e nenit 6.1 te Rregullorës mbi lartësinë e taksave ngarkesave dhe gjobave komunale 01 Nr.06-15345/1 dhe 01 Nr.06-8491/1

Drejtorati per Ekonomi Financa dhe Zhvillim ka pergatitur rregulloren për Subvencione.

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim ka pergatitur rregullorën per Tatimin në Pronë

Drejtorati per Ekonomi Financa dhe Zhvillim ka marre pjese neper degjime publike te organizuara ne asamblene komunale dhe neper fshatra per propozim buxhetin e vitit 2020.

**Njësia punuese e financave –** kjo njësi veprimtarinë e saj e ka përqendruar në:

Pranimin e aktvendimeve dhe kontratave të ndryshme nga ana e noterit për bartje të patundshmërisë.

Ka lëshuar vertetime dhe certifikata të ndryshme për shlyerjën e obligimeve tatimore rreth pranim-refuzimit të shtetësisë së Kosovës.

Ka ndihmuar sektorin e tatimit në pronë rreth shpërndarjës së faturave, inkasim, regjistrim të objekteve të reja dhe verifikim të objekteve.

Ka përpiluar dhe lëshuar certifikata të ndryshme subjekteve afariste mbi përmbushjën e obligimeve komunale.

Ky sektor punën e vet e ka bazuar në rregullorën mbi taksat komunale 01.Nr.06-1393/2 të datës 29.05.2013 dhe në bazë të kësaj rregullore ka lëshuar:

- Vertetime për bartje të pronësisë- 330
- Certifikata-vertetime të ndryshme për tendera nga bizneset -2
- Vertetimi-certifikata për pranim-refuzim të shtetësisë së Kosovës -111.

Më datën 31.01.2019 në kuvendin komunal është aprovuar ndryshimi dhe plotesimi I nenit 6.1të Rregullorës mbi lartësinë e taksave , ngarkesave dhe gjobave komunale Nr.01.06/13932/2 në të cilën është vendos: të gjitha bizneset individuale te cilat regjistrohen nga data 01.01.2019-31.12.2021 do të lirohen nga obligimi i pagesës së taksave në firmë.

**Njësia e Tatimit në Pronë**- zyra e tatimit në pronë në Dragash ka vepruar në harmoni me ligjin mbi tatimet në patundeshmëri Nr.06/L-005 dhe Udhezimin Administrativ mbi Organizimin dhe funksionimin e zyreve të tatimit në pronë Nr.10/2011.

Detyra kryesore e zyrës është qe për çdo vit të bëjë llogaritjen dhe fakturimin pronareve dhe shfrytezuesve te pasurive të patundëshme ( objekte banesore, industrial,komerciale,pyjore etj) shumat e tatimeve të cilat duhet të paguajnë për vitin e caktuar, si dhe të ndërmërrë të gjitha masat rreth inkasimit sa më të madhë të tatimeve në pronë.

Zyra e tatimit në pronë ka këtë personel: menaxheri i tatimit në pronë, dy operator për futjen e shenimeve në kompjuter, dy shpërndarës të faturave dhe një anketues-gjeodet.

Gjatë vitit 2019 ka arritur këto rrezulltate:

- Kemi printuar dhe kemi shpërndarë 18,500 fatura dhe certifikata te vleresimit te pasurise obliguesve tatimore, shuma e të cilave sillet 201,140.39 euro. Kemi bërë inkasimin e tatimit në pronë sipas SIMFK në shumë rreth 182,928.35 euro.
- Gjithsej kemi pranuar 46 ankesa nga qytetaret prej tyre 42 janë aprovuar dhe është vendos në favor të obliguesve tatimor, dhe 4 janë refuzuar si të pa bazuara ne ligj.
- Janë bërë rreth 200 ndryshime të ndryshme në bazë të kërkesave dhe ankesave të tatimpaguesve, siq janë: kontratat, ndryshimet e pronesisë, banimet primare-sekondare etj.
- Janë pranuar dhe zgjidhur 18 kërkesa për korigjimin e tatimpaguesve
- Është bërë vërifikimi i 2128 objekteve nëpër vendbanime te ndryshme .
- Janë regjistruar 164 objekte të reja
- Qytetareve për realizimin e të drejtave të tyre siq janë: regjistrimi i automjeteve, fletëparaqitje për pensione, për ndihma sociale, vertetimi i kontratave të ndryshme, pranimi dhe kthimi i shtetësisë, subvencionet etj u janë lëshuar 10,000 vertetime të ndyshme.

**Njësia e Thesarit**-është formuar me Udhëzimin Administrativ 02/2009 mbi delegimin e menaxhimit të shpenzimeve, janë bartë funksionet e procesimit të shpenzimeve nga thesari rajonal në atë komunal. Në kuadër të kësaj njësije funksionojnë zyrtari zotues, zyrtari i procesimit të urdhër pagesave –zyrtari i shpenzimeve, zyrtari i të hyrave vetanake dhe zyrtari i parave të imta.

Zyrtari zotues në periudhën janar –dhjetor 2019 kanë pregatitur rreth 1300 urdhër pagesa për shpenzimne ne shumen rreth 3,113,638.10 euro. Kujdes i veqant i është kushtuar mënyrës së drejtë të përgaditjës dhe futjës së zotimeve në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar dhe te Kontrollit

Zyrtari i shpenzimeve ka procesuarv rreth 3105 urdhër pagesa ne shumën 2,924,841.55 zyrtari certifikues ka bërë 3105 certifikime te urdhër pagesave me shumen rreth 2,924,841.55 si dhe arkivimin e të gjitha dokumentave të thesarit

Zyrtari i të hyrave vetanake ka bërë regjistrimin e 248 raporteve të të hyrave vetanake, ka pregatit 34 fletë alokime, 12 barazime vjetore për të hyra vetanake

Zyrtari i parave të imëta ka punuar në përgaditjën dhe terheqjën e parave nga banka ne vlerë 16,996.60 euro si dhe ka bërë pagesa me para të gatshme. Përveq kësaj ka pranuar nga zyrtaret e administrates paratë e inkasuara në vlerë 35,808.00 euro dhe të njejtat i ka deponuar në xhirollogarinë bankare të komunës.

Regjistrimin e pasurive me vlerë mbi 1000 euro dhe nen 1000 euro në SIMFK.

**Njësia-zyrtari përgjegjës në qendrën komunale për regjistrimin e biznesit**

Mbajtja e kontartave te shfrytezusve te perkoshem te objektve komunale me karakter te perkoshem dhe mbajtja e kontartave te prones komunale me shfrytezim afatshkurte dhe afatgjate ne baze te ankandeve te organizuara nga komisioni komunal per dhenien ne shfrytezim te pronës komunale i themeluar nga asambleja komunale.

Lëshuarjen e certifikatave të ndryshme në lëminë e tregtisë, hotelerisë, zejtarisë etj, gjithsej:12 Certifikata. Lëshuarjën e vërejtjeve për pagesë shfrytëzuesve të përkoshëm, gjithsej 120. Janë bërë regjistrimeve të bizneseve të reja, gjithsej 33, shuarje të bizneseve, gjithsej 08, ndryshime në biznes 34 , paisja me certifikata me unik, gjithsej 450.

Është punuar në plotësimin e formulareve të ndryshëm për regjistrimin e bizneseve dhe janë dhënë konsulta të ndryshme në lëminë e biznesit në harmoni me ligjin Nr.06/L-016.

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim rregullisht në baza mujore dhe periodike ka paraqitur raporte mbi realizimin e buxhetit për vitin 2019.

Përveq aktiviteteve të paraqitura më lartë zyrtarët e këtijë drejtoratri dhe të drejtorateve tjera kanë qenë bashkëpunues me auditorët e brendshem dhe te jashtem të cilët në vitin 2019 kanë bërë auditimin e PVF për vitin 2018 .

## Plani i punës i drejtorisë për Ekonomi Financa dhe Zhvillim -2020

Drejtorati për Ekonomi,Financa dhe Zhvillim i komunës së Dragashit, duke pas për bazë detyrat, obligimet dhe përgjegjësitë që dalin nga dispozitat ligjore dhe statuti i komunës së Dragashit, punën dhe veprimtarinë e vetë në vitin 2020 do ta përqendrojë në:

1.Menaxhimin e buxhetit ne baze të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësive, Ligjit mbi Financat e Pushtetit Lokal, Udhëzimeve Administrative dhe rregulave financiare të lëshuara nga MF dhe Komuna.

2. Monitorimin e regjistrimeve efikase dhe të sakta të të gjitha të hyrave, si dhe lehtësimin e rrjedhës së lirë të shpenzimeve në një mënyrë që është konsistente me rregullat e duhura të menaxhimit financiar dhe të bëjë regjistrimin e saktë të tyre.

3.Të përgatiten raporte financiare sipas kërkesave të Ligjit mbi Menaxhimin e Financave Publike në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit të sektorit publik i bazuar në paratë e gatshme dhe me statistikat qeveritare.

4.Të plotësohen nevojat për informata nga ana e palëve kryesore të interesuara, duke përfshirë Kuvendin, Qeverinë, Donatorët, komunitetin dhe publikun

5. Të siguroj që të bëhet barazimi sipas kërkesave te LMFPP në mes të SIMFK-së dhe Organizatës buxhetore.

6. Rritja e efikasitetit në punë në arkëtimin e të hyrave vetanake, tatimit në pronë, taksave dhe ngarkesave të ndryshme komunale dhe mundësia e gjetjës së burimeve tjera financiare, përmes donacioneve apo formave tjera,

7. Rritja e transparencës në nivelin me të lartë, para qytetarëve në grumbullimin, shfrytëzimin dhe shpenzimin e parasë publike.

8. Propozimi i rregulloreve financiare ne asamblene komunale

**PLANI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR - DHJETOR 2020**

| Nr | Përshkrimi i detyrave të planifikuara | Afati |
|---|---|---|
| 1 | Regjistrimi dhe raportimi mbi të hyrat vetanake të komunës | Detyrë e përhershme |
| 2 | Regjistrimi dhe ekzekutimi i urdhërpagesave në SIMFK | Detyrë e përhershme |
| 3 | Regjistrimi dhe terheqja e avanseve për pagesa me para të gatshme. Pranimi i parave nga inkasimi dhe dorezimi ne llogarine bankare te komunes dhe pergatitja e raporteve. | Detyrë e përhershme |
| 4 | Regjistrimi i pasurise mbi 1000 euro ne SIMFK dhe regjistrimi ne e-pasuri nen 1000 euro | Detyre e perhershme |

| | | |
|---|---|---|
| 5 | Regjistrimi i bizneseve, konsullta të ndryshme rreth bizneseve, mbajtja e kontratave pasi qe ato te nenshkruhen per ngarkim te qirase, pagesa e qirave ne baza mujore. | Detyre e perhershme |
| 6 | Shtypja e faturave, specifikat dhe vleresimet e tokave per tatimpaguesit te cilet jetojnë në Komunën e Dragashit. Informimi i tatimpaguesve rreth aplikimit te tatimit ne tokë. | Shkurt 2020 |
| 7 | Shperndarja e faturave të tatimit në pronë<br>Leshuarja e aktvendimeve mbi ngarkesën e qirave vjetore për shfrytëzimin e tokës ndertimore<br>Barazimi i te hyrave vetanake dhe shpenzimeve me te dhënat nga SIMFK | Shkurt-Mars<br>Mars<br>Fundi i Marsit |
| 8 | Pranimi i ankesave dhe vrejtjeve nga qytetaret per faturat e tatimit ne prone | Mars |
| 9 | Raporti periodik mbi shpenzimin e mjeteve buxhetore për periudhën janar –mars 2020 | Fundi i prillit 2020 |
| 10 | Raporti mbi numrin e bizneseve të regjistruara pranë qendres për regjistrimin e bizneseve në Dragash, | 15 prill 2020 |
| 11 | Seleksionohen, verifikohen dhe printohen faturat e borgjlinjeve më të mëdhenj të tatimit në pronë perseri tu shperndahen faturat dhe nese nuk paguhen borxhet te ndermerren masa te parapara me ligj per pagese te detyruar | Korrik 2020 |

| | | |
|---|---|---|
| 12 | Regjistrimi i te gjitha objekteve te reja te ndertuara dhe verifikimi i objekteve tjera egzistuese. Leshuarja e vertetimeve dhe dokumenteve ( vertetimi per regjistrim te automjetit, per ndihma sociale, per viza etj ) | Detyre e perhershme |
| 13 | Bartja e shitblerjeve të kontratave dhe bashkpunimi me MEF, Departamenti i tatimit ne pronë | Detyrë e përhershme |
| 14 | Raporti mbi inkasimin e mjeteve nga shfrytezimi i tokes dhe objekteve ne pronesi te komunes me karakter te perkoheshem | Detyre e perhershme |
| 15 | Pagesa e tatimit, leshuarja e certifikatave të ndryshme për pagesën e tatimit dhe regjistrimi i objekteve të reja | Detyrë e përhershme |

| | | |
|---|---|---|
| 16 | Pëgaditja dhe procesimi i urdhër zotimeve për pagesë | Detyrë e përhershme |
| 17 | Pëgaditja e raportit të shpenzimeve dhe të hyrave për periudhën janar-qerrshor 2020 | Korrik 2020 |
| 18 | Debat publik rreth projekt propozimit të Buxhetit për vitin 2021 | Korrik 2020 |
| 19 | Përgaditja dhe shqyrtimi i Rregullores për vendosjen e tatimit në Pronë për vitin 2021 (varsisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave) | Fundi i Tetorit |
| 20 | Debati i dytë lidhur me buxhetin 2021-2023 (varsisht nga Qarkoret Buxhetore të cilat i lëshon Ministria e Financave) | Gusht 2020 |
| 21 | Shqyrtimi i Projekt Buxhetit për vitin 2021 -2023 | Shtatori 2020 |
| 22 | Shqyrtimi i Raportit mbi realizimin e buxhetit për periudhën janar-shtator 2020 | Tetor 2020 |

| | | |
|---|---|---|
| 23 | Punët përgaditore rreth përmbyllje së UZP sipas afateve të cilat i përcakton MEF-i -Departamenti i Thesarit | Nentor 2020 |
| 24 | Punët e përmbylljes së vitit buxhetor 2020 | Dhjetori 2020 |

Drejtorati për Ekonomi Financa dhe Zhvillim do të bashkëpunojë ngusht me institucionet qeveritare të Republikës së Kosovës. Varsisht nga plani dhe programi i Ministrive përkatëse, punëtorët e këtij drejtorati do të jenë pjesëmarres të aktiviteteve në trajnime dhe ligjrata të cilat do të organizohen nga ministritë dhe asociacionet.

Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality

# R A P O R T

**I PUNËS SË DREJTORATIT TË ARSIMIT, për vitin 2019**
**&**
**Planin e Punës, për vitin 2020**

**Drejtori: Vloran Cenaj**

**Dragash,________2020**

Drejtoria për Arsim në vitin 2019 ka realizuar aktivitetet e veta në kuadër të dinamikës dhe vëllimit të punës të përfshira në planin e veprimit për këtë vit. Realizimi i detyrave të punës është bërë në harmoni të plotë me Statutin e Kuvendit Komunal, Ligjin për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 , dhe Udhëzimeve Administrative të nxjerra nga MASHT-i.

Në komunën tonë funksionale janë 36 objekte shkollore dhe atë:

| Shkolla AMË | Shkolla Satelite | SHML – Mesme të larta |
|---|---|---|
| 12 | 23 | 1 |

Të gjitha këto shkolla janë në kuadër të arsimit publik ngase në territorin e komunës së Dragashit nuk funksionon asnjë shkollë private.

Procesi arsimor është i organizuar në këto nivele:

- Arsim parafillor- organizohet me qëllim të përgatitjes së fëmijëve për vazhdimin e shkollës fillore dhe funksionon në kuadër të objekteve të shkollave fillore.

- Arsim fillor – në kuadër të këtij niveli përfshihen klasat 1-5 gjegjësisht moshat 6 deri në 10 vjeç,

- Arsimi i mesëm i ulët - përfshin klasat 6-9 gjegjësisht moshat 11 deri në 14. Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët është i obliguar dhe zgjat 9 vite.

- Arsimi i mesëm i lartë- është i organizuar në:
  - Arsimin e përgjithshëm (gjimnaz),
  - Arsimin profesional.

Kohëzgjatja e këtij niveli është 3 vjet varësisht nga profilet arsimore të përcaktuara nga MASHT-i dhe përfshin moshat prej 15 deri në 17 vjeç.

Në Sektorin për Arsim punojnë 6 punëtorë përfshirë edhe drejtorin e drejtorisë kurse në të gjitha nivelet arsimore janë të angazhuar 477 punëtorë nga të dy komunitetet. Në këtë vit shkollor numri i nxënësve në institucionet edukative-arsimore të komunës së Dragashit është 3671. Duke i përfshi arsimin parashkollore fillor dhe te mesme .

Vitin shkollor **2019/20** e kanë ndjekur 3671 nxënës, të grupuar në 392 paralele, të shpërndarë në:

12 Shkolla Fillore të Mesme të Ulëta;

23 Paralele të ndara të Shkollave Fillore;

1 Shkollë të Mesme të Lartë (Mikse);

Detajet tjera sipas niveleve shkollore mund t'i shihni në tabelarin dhe grafikonin e mëposhtëm:

**Tabelari i nxënësve sipas niveleve**

| Niveli | Paralele | Femra | Meshkuj | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|
| Arsimi Parafillor | 18 | 131 | 169 | 300 |
| Arsimi fillor (1-5) | 137 | 753 | 786 | 1539 |
| Arsimi i mesëm i ulët (6-9) | 207 | 601 | 646 | 1247 |
| Arsimi i mesëm i lartë (10-12) | 30 | 284 | 301 | 585 |
| Total | **392** | **1769** | **1902** | **3671** |

Gjatë punës një vjeçare janë punuar 743 lëndë administrative të cilat janë paraqitur sipas kërkesave e nevojave të shkollave, punëtorëve dhe organeve komunale.

Drejtoria e Arsimit edhe brenda këtij viti ka arritur që të sjellë transparencë në këtë resor dhe të përfundoj hartimin e rregullorës për arsimin parauniversitar në komunën e Dragashit.

Drejtoria e Arsimit ka bërë mbikëqyrjen e procesit edukativo-arsimor, mbikëqyrje e cila është duke u realizuar në vazhdimësi nga drejtori dhe zyrtarët komunal të arsimit;

Sipas dinamikës së planifikuar, zyrtarët e arsimit kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, speciale, kontrolluese dhe të përgjithshme në institucionet e arsimit përkatësisht në shkollat fillore të mesme të ulëta dhe në shkollën fillore të mesme të lartë në komunën e Dragashit. Në kuadër të mbikëqyrjes profesionale dhe kontrollit të vazhdueshëm të ecurive dhe zhvillimeve në procesin e institucioneve edukativo-arsimore të komunës së Dragashit, zyrtarët e Drejtorisë së Arsimit sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë gjatë këtyre muajve, kanë realizuar vizita speciale dhe kontrolluese në institucionet arsimore.

Zyrtarët e lartë të arsimit, gjatë muajit janar, shkurt, mars, prill, maj dhe qershor kanë realizuar vizita informuese në institucionet edukativo-arsimore, vizita kontrolluese në; shkollën fillore të mesme të ulët "Fetah Sylejmani" në Dragash, "Sezai Surroi"-Bellobrad, "Shaban Shabani"-Llopushnik, "Ulina"-Kosavë, "Samidin Emini"-Kuk, "28 Nëntori"-Bresanë, "Ilmi Bahtijari"-Blaç," Restelica" në Restelicë, "Zenuni"-Brod ndërsa vizita speciale në shkollën fillore "Svetlost-Krushevë" për ta shqyrtuar ankesën e drejtuar në DKA; gjithashtu vizita edhe shkollës së mesme të lartë "Ruzhdi Berisha" në Dragash.

-Në muajin Qershor është bërë kompletimi dhe dërgimi i të dhënave në MASHT me qëllim të publikimit të konkursit për regjistrim të nxënësve në SHML (Shkollën e Mesme të Lartë) për të vazhduar me hapjen e konkrusit për regjistrimin e nxënësve dhe përcjelljen e procedurës së regjistrimit të nxënësve në shkollën e mesme të lartë.

-Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasëve parashkollore dhe fillore

-Shpallja e konkursit të rregullt për plotësimin e vendeve të lira të punës

-Furnizimi i shkollave me dokumentacion pedagogjik: ditarë pune, librat të kujdestarisë si dhe kalendarin shkollor

-Përcjellja e punës së shkollave për realizimin e ekskursioneve të maturantëve dhe semimaturanteve.

-Në muajin shtatot është bërë hartimi i dinamikës dhe përcjellja e fillimit të vitit shkollor, vizitë në shkolla me qëllim të urimit të nxënësve dhe arsimtarëve.

-Vazhdimi i bashkëpunimit me lidhjet e krijuara me drejtori komunale dhe shkolla të shteteve të ndryshme si dhe krijimi i lidhjeve të reja me interes për shkollat dhe arsimin në Dragash këtu vlen të permendet binjakezimi i shfmu Samidin Emini - Kuk me shkollen nga rrethi i Kukesit dhe binjakezimi i shfmu Shaban Shabani me shkollen e Shishtavecit,

-Bashkëpunimi me MASHT-in, Zyrën Rajonale të Inspeksionit në fushën e arsimit

-Përgatitja dhe regjistrimi i nxënësve të klasëve parashkollore dhe fillore.

- Arsimi dhe edukimi çelësi i çdo suksesi. Ky projekt është duke u financuar nga Ambasada e SHBA-së në Kosovë.

-Është bërë kontrollimi dhe vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve të cilët kanë ndjekur trajnimin nga 09.07.2018 deri më 14.07.2019 dhe 13.10.2018-28.10.2019 .

-Janë duke u mbajtur trajnime permanente për zhvillimin profesional të personelit edukativo arsimor, në bashkëpunim (MASHT, OJQ-të);

- Së bashku me kryetarin e komunës janë takuar me përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve të shkollave dhe drejtorët e shkollave në Dragash, me të cilët është diskutuar rreth situatës aktuale, kohë kur greva e përgjithshme e mësimdhënësve kishte hyrë në ditën e dhjetë.

- Së bashku me përfaqësues nga zyra e Koordinatorit Nacional për Kulturë, Rini dhe Sport dhe me zëvendësministrin e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Azem Guri, prezantuan para drejtorëve të shkollave të Komunës së Dragashit Programin Nacional për Rininë.

- Drejtoria e Arsimit dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë e Sportit kanë organizuar manifestimin tradicional "Festivali Rinor 2019", të gjashtëmbëdhjetin me rradhë.

-Është përfunduar vlerësimi i dosjes së mësimdhënësve të nivelit parafillor, klasën e parë, klasën e gjashtë dhe klasën e dhjetë, të cilët nga shtatori i vitit 2018, kanë filluar me zbatimin e KKK së re;

-Për herë të parë Drejtoria e Arsimit në Dragash dhe Shoqata e Matematikanëve të Kosovës organizojnë Olimpiadën Matematike. Nga kjo u caktuan përfaqësuesit e Komunës së Dragashit në Olimpiadën XI Matematike të Kosovës e cila u mbajt në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë (Rr. Tahir Zajmi, Nr. 65, Kalabri).

-Drejtoria e Arsimit në Dragash vazhdoi me organizimet e suksesshme, kësaj rradhe me Garat Republikane të Fizikantëve të Rinj të Dragashit të cilat u mbajtjen: 3 mars 2019 (e dielë) në sallën e Kuvendit Komunal në Dragash.

-Vizituam shkollat e Komunës së Dragashit, ku u takuam me nxënësit të cilët ishin përzgjedhur si tre më të mirët në shkollën e tyre për poezinë dhe esenë më të mirë të shkruar rreth 11 Vjetorit të Pavarësisë së Republikës së Kosovës.

-Drejtori i Arsimit në mbështetje të kompetencave të tij ligjore dhe në pajtim me rekomandimin e kryetarit të komunës së Dragashit ka miratuar vendimin për ndarjen e mirënjohjeve për mësimdhënësit e pensionuar nga data 07/03/2018 deri me 07/03/2019

-Përfunduam punimet e fundit rreth rregullimit të fushës së sportit në shkollën fillore "Shaban Shabani" në Pllavë.

- Në SHFMU "Sezai Surroi" në Bellobrad është mbajtur gara e Kimisë edhe në komunën e Dragashit.

-Policia e Kosovës dhe Drejtoria e Arsimit në Dragash organizuan një ligjeratë me nxënësit e SHML" Ruzhdi Berisha"-DragashTema: "Parandalimi i Ekstremizmit".

-Sipas strategjisë dhe Planit të Veprimit 2017-2021 të Policisë së Kosovës, stacioni policor Dragash respektivisht zyra për Komunitet dhe Zyrtari Rajonal për Projekte dhe Parandalim të Krimit rreshter Vesel Gashi, kanë organizuar një takim me Drejtorin e DKA-së Vloran Cenaj dhe drejtorët e shkollave fillore dhe asaj të mesme të komunës sonë. Tema e takimit ka qenë "Siguria në shkolla".

-Me rastin e "Ditës Botërore të Ujit" (22.03.2019) Drejtoria e Arsimit në Dragash dhe KRU "Hidroregjioni Jugor" SH.A Prizren kanë organizuar garën e diturisë "SA DIMË PËR UJIN"

-Vlerësimi ndërkombëtar TIMSS, i cili po organizohet me nxënës të klasës së katërt për matematikë dhe shkenca natyrore, e që është me besueshmëri më të lartë dhe ndikim të rëndësishëm në zhvillimin e politikave arsimore të vendeve që marrin pjesë.

-Drejtoria e Arsimit dhe Organizata Jo qeveritare THY përfitues i Programit ERASMUS+ më datën 30.04.2019 në orën 11, në sallën e Kuvendit Komunalnë Dragash ka mbajtur një takim me nxënësit maturantë, me temë "Orientimi në karrierë".

-Me kërkes të DKA-së fillojnë vizitat sistematike shëndetësore për nxënësit e komunës së Dragashit

-Në të gjitha shkollat e komunës së Dragashit janë mbajtur Garat Nacionale të Diturisë në formën e testeve për të gjithë nxënësit nga klasa e I-rë deri në klasën e XII-të.

-Në SHFMU "Restelica" në Restelic së bashku me Cory Schmidt - Zëvendës Udhëheqës i Ekipit për Mbështetje Civile Ushtarake nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, ku u pritën nga drejtori i shkollës Jusuf Hoxha i cili i shpalosi prioritetet e shkollës.

-Është shënuar Dita Olimpike 2019 është organizuar edhe në Komunën e Dragashit nga Komiteti Olimpik i Kosovës, në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorinë Komunale të Arsimit të Komunës sonë.

-Më 31.05.2019 në lokalet e shkollës së mesme "Ruzhdi Berisha" në Dragash u mbajt Testi i Arritshmërisë për të gjithë nxënësit e klasëve të 9-ta nga 12 shkolla të mesme të ulëta të komunës sonë.

-Drejtoria e Arsimit në bashkëpunim me MASHT kanë organizuar trajnimin për ngritjen e kapaciteteve për Menaxhim dhe Udhëheqje.

- Në sallën e Kuvendit Komunal të Dragashit drejtori i Arsimit Vloran Cenaj i shoqëruar dhe nga zyrtarë komunal për arsim kanë takuar administruesit e testit të maturës nga Dragashi.

**Testi i Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2019/2020**

Testi i Maturës Shtetërore është mbajtur në dy afate:

**Afati i Qershorit** 14.06.2019 (e premte), pjesa e parë në lëndët: gjuhë amtare dhe gjuhë angleze dhe pjesa e dytë me 21.06.2019 në lëndët: matematikë dhe lëndëndë zgjedhore.

**Afati i Gushtit** (30.08.2019 gusht dhe 07.09.2019). Në test kanë marrë pjesë maturantët e SHML-së " Ruzhdi Berisha" me gjithsej **109** maturantë.

**Testi i Maturës Shtetërore për vitin shkollor 2019/2020**

| Shkolla | Përqindja e kalueshmërisë |
|---|---|
| Ruzhdi Berish | |
| **Total** | **59.17 %** |

- Pjesa e parë testit të maturës **2018/19** u mbajt më **14.06.2019** ( e premte), nga lëndët : **Gj.shqipe.** gj. **angleze** ; poashtu edhe për komunitetin boshnjak nga: **Gjuha boshnjake, gj. angleze .**

Pjesa e dytë e testit të maturës është mbajtur më **21.06.2018** ( e premte) nga lëndët: **Matematikë** dhe **1 lëndë zgjedhore** për të dy komunitetet.

Testit i nënshtrohën **183** nxënës të komunitetit shumicë shqipëtar dhe **20** nxënës të komunitetit pakicë boshnjak.

Nga **175** nxënës të komunitetit shumicë shqipëtar; **97** nxënës e kalojnë testin e maturërës, kurse **78** nxënës nuk e kalojnë testin e maturës.

Nga komuniteti pakicë boshnjak testit të maturës i nënshtrohën **20** nxënës, prej tyre **17** nxënës e kalojnë testin e maturës kurse **3** nxënës nuk e kalojnë testin e maturës.

-Garat Nacionale të Diturisë në Nivelin Komunal.

-Dretori i Arsimit Vloran Cenaj ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me përfaqësues të Busulla. Com. Busulla.COM është platformë zyrtare e MASHT-it për këshillim dhe orientim në karrierë.

-Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash në koordinim me MASHT edhe këtë vit ka vazhduar me trajnimin e mësimdhënësve për realizimin dhe zbatimin e Kurrikulës së re për vitin shkollor 2019/20.

-Pjesa e parë e afatit të dytë të Testit të Maturës në komunën e Dragashit

-Është mbajtur pjesa e dytë e afatit të dytë të Testit të Maturës në komunën e Dragashit

-Nxënësit fitues të nivelit republikan të garave në kuadër të Programit Nacional për Rininë nga komuna e Dragashit, po qëndrojnë në Shqipëri për kampet kreative.

-Kampi Rinor i organizuar nga Drejtoria e Arsimit në Dragash në bashkëpunim me UNDP dhe në partneritet me njësitë e Policisë së Kosovës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare.

-Drejtoria e Arsimit në Dragash ka vazhduar me organizimin e trajnimit gjashtë ditor me mësimdhënësit për zbatimin në praktik të Kurrikulës së Re .

-Fituesit e garave republikane të klasave VI-IX edhe nga komuna e Dragashit po mbajnë kampet kreative

-Drejtoria e Arsimit në Dragash dhe Ambasada Britanike në Kosovë organizojn trajnimin dy-ditor " Gjithëpërfshirja Sociale Përmes Aktiviteteve në Natyrë" me nxënës të shkollës së mesme "Ruzhdi Berisha" në Dragash

-Vazhdojnë garat në Kreativitet Kulturor dhe Mendim Kritik në komunën e Dragashit

-Shkollat e komunës së Dragashit pjesë e programit "Shkollat e shekullit 21"

-Drejtoria e Arsimit mundëson çasje në Arsim për fëmijët nga Shqipëria.

-Drejtoria e Arsimit në Dragash në bashkëpunim të ngushtë me Organizata Nderkombetare për Migrim, IOM dhe MASHT janë të përkushtuar për zbatimin e Planit të Veprimit dhe Strategjisë për Parandalimin e Ekstremzimit të Dhunshëm 2015-2020.

-Marrëveshje mes Drejtorisë së Arsimit në Dragash dhe Qendrës për Shërbime Humane dhe Zhvillim -QSHHZH për hapjen e Qendrës Komunitare për fëmijët e grup moshave 3-6 vjeç.

**Testi i Arritshmërisë për vitin shkollor 2019/2020**

Nga gjithsej **301** nxënës semimaturant, testit i'u nenshtruan gjithsej **297** semimaturantë nga gjithsej **12** shkolla fillore: **6** të komunitetit shqiptar me **269** nxënës dhe **6** shkolla të komunitetit boshnjak me **28** nxënës.

**284** nxënës shqiptar dhe **28** nxënës boshnak e kaluan testin

**Semi-matura 2019 Qershor**

| Shkolla | Nr.i nx. që iu nënshtruan testit të semi-maturës | Përqindja e arritshmërisë |
|---|---|---|
| SHML" Ruzhdi Berisha" | 301 | |
| Gjuhë Shqipe | 269 | 89.36 % |
| Gjuhë Boshnjake | 28 | 9.30 % |
| **Gjithsej** | 297 | 98.67 % |

-Është bërë furnizimi me lëndë djegëse në shkollat e komunës së Dragashit, pas përmbylljes së procedurës së ofertës publike për lëndët djegëse për vitin shkollor 2019 /2020, ka nisur furnizimi i shkollave me lëndë djegëse/ dru dhe pellet, ky proces është përmbyllur shpejt dhe në përputhje me kushtet e kontratës.

**Trajnimi i mësimdhënësve për Zbatimin e Kornizës së Re të Kurrikulës së Kosovës**

Në vitin shkollor 2019/20 ka filluar së zbatuari Kurrikula e Re e Kosovës, në të gjitha shkollat (me përjashtim të shkollave profesionale që nuk është finalizuar ende kurrikula bërthamë. Për ta zbatuar me sukses këtë proces, në bashkëpunim me MASHT-in kemi organizuar trajnimin e të gjithë mësimdhënësve në komunën e Dragashit, të cilët do të punojnë në vitin shkollor 2019/20 me kurrikulën e re. Gjithesej janë trajnuar mësimdhës në fushat e kurrikulës: 66 mësimdhënës.

**Republika e Kosovës- Republic of Kosovo**

**Komuna Dragash – Municipality Dragash**

**Drejtoria Komunale për Arsim**

# Plani një vjeçar i punës 2019/2020

| Plani i punës në Drejtorinë Komunale të Arsimit për vitin shkollor 2019/2020 | KOHA E REALIZIMIT | | | | | | | | | | | | Implementues |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **24.** | **Orientimi i Rinisë në Studime dhe në Lidership**<br>✓ Më 06.11.2019, në Gjimanzin "Ruzhdi Berisha" në Dragash, u mbajtë trajnimi i dytë, ku përmes këtij trajnimi maturantët u informuan dhe trajnuan lidhur me mundësitë e tyre për aplikime për punë, punë praktike, studimet e mëtejshme Bachelor, si dhe gjetjen dhe aplikimin e bursave të ndryshme ndërkombëtare.<br>✓ Ky projekt u zhvillua në bashkëpunim me OJQ IRSHD | **35 persona** | **IRSHD** | **Nëntor** |
| **25.** | **28 Nëntori – Dita e flamurit**<br>✓ Akademi Përkujtimore, vendosja e kurorave tek shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari në Dragash dhe në varrezat e dëshmorëve në Dragash e në fshatin Buçe. | **100 persona** | **Përfaqësues të lartë të Komunës, asambleistë, familje të dëshmorëve, qytetarë** | **Nëntor** |
| **26.** | **Takimi i tretë me akterët relevantë të Komunës së Dragashit** | **30 persona** | **Përfaqësues të lartë të Komunës,** | **Dhjetor** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | ✓ Diskutime me komunitetin e Komunës së Dragashit lidhur me këto tema:<br>1.Transporti publik<br>2. Qentë endacak<br>3. Deponitë ilegale<br>4. Ndriçimi public<br>✓ Diskutimi u zhvillua në bashkëpunime me Q.R Avoko dhe Democracy Plus | | **Qendra Rinore Avoko, Democracy Plus, qytetarë** | |
| **27.** | **Organizimi i turneut të me shkollat e futbollit**<br>✓ Ekipe pjesëmarrëse nga Kosova dhe Kumanova | **500 persona** | **Përfaqësues të lartë të Komunës, shkolla të futbollit, qytetarë** | **Dhjetor** |
| **28.** | **Promovimi i rinisë aktive**<br>✓ Në kuadër të këtij projekti u vendosën fotot në Shtëpinë e Kulturës në Dragash, të cilat prezantojnë trashëgiminë kulturore, dhe vendet turistike të Komunës së Dragashit.<br>✓ Projekti u zhvillua në bashkëpunime me Q.R Avoko | // | **Përfaqësues të DKRS-së, OJQ Avoko, vullnetarë të Korpusit të Paqes** | **Dhjetor** |

Nga kjo del se të përfshirë në aktivitetet e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport kanë qenë shumë qytetarë të Komunës së Dragashit, ku varijon nga 50 deri në 8.000 persona, varësisht nga lloji i aktivitetit. Krahasuar me vitin e kaluar numri i aktivitetve është shtuar dhe pjesëmarrja e qytetarëve në aktivitete është rritur.

Brenda këtij viti, në kuadër të kodit të subvencioneve, Komuna e Dragashit ka ndarë mjete për klubet sportive, OJQ-të kulturore, OJQ-të sportive dhe për OJQ-të rinore me anë të thirrjes publike, të bazuar në Rregulloren mbi Financimin Publik të OJQ-ve. Krahasuar me vitet paraprake kjo shumë është trefishuar, ku fokus të veqantë i është kushtuar sportit me 27,000 euro subvencionim, kulturës 12,000 euro dhe rinisë 10,000 euro.

Drejtori i DKRS-së

______________________

**Lirim Hajredini**

Republika e Kosovës/ Republika Kosova/ Republic of Kosovo
Komuna e Dragashit/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality

*Për:* **Kryetarin e Komunës z.ShabanShabani**

*Nga*: **Drejtori për Kulturë Rini e Sport z.Lirim Hajredini**

## Plani i punës së DKRS për vitin 2020

Në përputhje me Statutin e Komunës së Dragashit, përshkrimin e vendeve të punës dhe detyrimeve të drejtorisë, si dhe me stafin në dispozicion e me buxhetin e vitit 2020, Drejtoria për Kulturë Rini e Sporti paraqet këtë plan të punës:

- Organizimi i shënimit të datave të festave shtetërore e komunale, në përputhje me Ligjin mbi Festat Shtetërore të Republikës së Kosovës dhe Komunës së Dragashit si dhe aktivitetet e parapara për vitin 2020, siç janë:

✓ *Rëndësia e librit- ligjërata në të gjitha shkollat*
✓ *17 Shkurti- Dita e Pavarësisë së Republikës së Kosovës*
✓ *Kursi i gjuhës angleze „Leadership Club", 3 muaj*
✓ *Epopeja e UÇK-së*
✓ *7 Marsi- Kuizi i Diturisë*
✓ *Realizimi i thirrjeve publike për Subvencionim të OJQ-ve*
✓ *Java e Bibliotekës*
✓ *Dita Olimpike 2020*
✓ *Ora letrare „Sofra e Ymer Prizrenit"*
✓ *Festivali Rinor*
✓ *15 Qershori - Dita e Çlirimit të Dragashit*
✓ *Festivali Mbarëkombëtar Folkloriko-Burimor "Opoja Vallëzon"*
✓ *Turneu i futbolli "Bresana e Bashkuar"*
✓ *Ditët e Diasporës*
✓ *Java e Sportit*
✓ *28 Nëntori -Dita e Flamurit kombëtar*
✓ *Turneu i futbollit me shkollat e futbollit*

- Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për realizimin e projekteve për të gjithë sektorët, sa herë që paraqiten kërkesat.

- Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, do të intesifikohen angazhimet për vazhdimin e punimeve të Palestrës Sportive në hapësirën e Qendrës së Biznesit.

- Themelimi i klubeve të reja sportive dhe ofrimi i mbështetjes materiale për ato ekzistuese.

- Do të vazhdohet bashkëpunimi me OJQ-të tjera ndërkombëtare e vendore për restaurimin e objekteve të trashëgimisë kulturo- historike.

- Në bashkëpunim me Zyrën Ligjore do të intensifikohen angazhimet për hartimin e rregullores për licencimin dhe mënyrën e funksionimit të Qendrave Rinore në territorin e Komunës së Dragashit

- Hartimi i Planit të Veprimit Rinor Lokal dhe miratimi në Asamblenë Komunale,

- Hartimi dhe miratimi i Statutit të Muzeut Etnografik në Asamblenë Komunale.

- Do të bashkëpunohet dhe do t`u ofrohet ndihmë të gjithë individëve e shoqatave, apo klubeve me karakter kulturor, sportiv dhe rinor në territorin e komunës përmes thirrjeve publike.

- Do të bëhen përpjekje për sigurimin e mjeteve për aktivitete sportive me punëtorët dhe zyrtarët e të gjitha drejtorive në kuadër të Komunës së Dragashit.

- Do të shtohet angazhimet për mbarvajtjen dhe kryerjen me përgjegjësi të punëve të të gjithë zyrtarëve dhe punëtorëve të DKRS-së.

Drejtori i DKRS-së

______________________

**Lirim Hajredini**

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

# RAPORT

**I PUNËS SË DREJTORATIT TË BUJQËSISË, TURIZMIT, ZHVILLIMIT RURAL DHE INSPEKCION, për vitin 2019 & Planin e Punës, për vitin 2020**

**Drejtori: Fejsal Haliloviq**

**Dragash,________2020**

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO**
**REPUBLIK OF KOSOVO**
**Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash**
Drejtorati për Inspeksion, Bujqësi, Pylltari, Turizëm dhe Zhvillimit Rural
Direktoriat za Inspekciju, Poljoprivredu, Turizam, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Directorate for Inspections, Agriculture, Tourism, Forestry and Rural Development

**Të nderuar!** Në bazë të dispozitave ligjore në fuqi për rolin dhe kompetencat e Drejtoratit, Planit të Punës dhe detyrave të parapara konkrete për vitin 2019, aktivitetet kryesore dhe detyra konkrete të Drejtoratit, për vitin 2019 kanë qenë, si vijon:

**<u>SEKSIONI PËR BUJQËSI, TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:</u>**

**Bashkpunimi me MBPZHR**: Duke pasur parasysh se politika agrare shtetërore definohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Drejtorati për Bujqësi, Inspekcion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, përmes Seksionit për Bujqësi dhe Turizëm, ka realizuar bashkëpunim të plotë me MBPZHR, dhe zyrën regjionale të MBPZHR në Prizren, për t'u siguruar fermerëve rrugën më të shkurtër të shërbimeve dhe përfitimit të mjeteve të pagesës së drejtpërdrejtë (subvencioneve), si dhe mjeteve të Grantit për përparimin e bujqësisë. Projekti ka paraparë subvencione e prodhimtarisë blegëtorale (lopë mjelëse dhe dele), bletarisë, pemëtarisë, mbjellja e kulturave agrare si dhe produktet e qumështit

Mjetet e Grantit kanë qenë të destinuara për rikonstruktimin dhe ndërtimin e fermave për lopë mjelëse dhe dele, për ferma të pulave vojse, përkatësisht vezëve të konsumit dhe prodhimtari blegëtorale, si dhe mjete për prodhimtari bimore, siç është ndërtimi i serave, përkatësisht prodhimtaria e perimeve në hapësira të mbyllura, themelimi i plantacioneve të pemëve me kulturën-mollë, si dhe plantacioneve të dredhëzave, manaferrave etj.

**Subvencione dhe grantet:**

**<u>Prodhimtaria e deleve:</u>** Ka përfunduar projekti i subvencionimit në prodhimtarinë e deleve, për dele kanë aplikuar **64 fermerë,** përkatësisht **10,784** dele dhe për dhitë **3 fermerë** përkatësiht **113 dhi.**

**<u>Prodhimtaria blegëtorale:</u>** Është kryer projekti i subvencioneve në prodhimtarinë blegëtorale, përkatësisht lopë mjelëse, kanë aplikuar **180 fermerë** me fondin blegëtoral prej **1836 frymëve.** Fermerë me prodhimtari të kombinuar të **lopëve-deleve-pemëve-mbjellje agrare** kanë qenë **48.**

**<u>Prodhimtaria e bletarisë:</u>** Ka përfunduar projekti i subvencionimit në prodhimtarinë e bletarisë, kanë aplikuar **50 bletarë,** përkatësisht 3053 **koshere bletësh.**

**<u>Prodhimtaria e vezëve:</u>** Ka përfunduar projketi i subvencionimit për pulat vojse, në prodhimtarinë për pula vojse kanë aplikuar **2 fermerë**, përkatësisht **6900 pula vojse** dhe për thëllëza **3 fermerë**, përkatësisht **2460 thëllëza vojse.**

**<u>Përpunmi i qumështit:</u>** Qumështoret lokale për **gjashtë muaj të 2019,** kanë grumbulluar rreth **743995** litre qumësht nga **35 fermerë.**

**<u>Mbjelljet pranëverore e vjeshtore dhe të korrurat:</u>** Me sukses kanë përfunduar mbjelljet dhe korrjet si dhe aplikmi për subvencione të fermerëve. Subvencionet për farëra i kanë realizuar **12 fermerë, për 32 ha.** Korrja është zhvilluar në **220 ha** me të arriturat mesatare prej **2450 kg/ha,**

**<u>Prodhimtaria e pemëve dhe perimeve:</u>** Subvencionet për pemë dhe perime i kanë fituar **28 fermerë, për 12.20 ha.**

**<u>Është bërë bashkëpunimi i plotë me MBPZHR</u>**

**Përpunimi i informacioneve dhe njoftimeve për fermerët lidhur me pjesëmarrjen në konkurse:** ndihma dhe infrormatat u janë dhënë fermerëve për grumbullimin e dokumentacionit të caktuar për konkurs.
**Bashkëpunimi me zyrën rajonale të bujqësisë në Prizren:** Lajmërimet dhe mbështetja për konkurs në projektet e Granteve dhe Subvencioneve (bletë, lopë qumështore, dele, dhi), organizimi i seminarit se si të bëhet një biznes plan për pjesëmarrje në Grante.
**Këshilla për fermerë dhe grupe të fermerëve:** Organizimi i trajnimeve për fermerët në prodhimtarinë blegtoriale. Aktivitetet bëhen në teren si dhe në hapësirat e sektorit.
**Bashkëpunimi me UNDP-në**: **Shtatë fermerë** kanë realizuar të drejtën për Grant nga ana e LDF-së, janë ndërtuar 10 pushimore, organizimi i seminarëve profesional me angazhim të ekspertëve specijal, është formuar një OJQ me detyra të afirmimit dhe përparimit të turizmit rural të komunës së Dragashit, gjithashtu janë riparuar tre shtëpi për nevoja të turizmit rural.
**Bashkëpunimi me CARTIAS-in:** Është realizuar projekti për bletari dhe pemëtari (mjedra, boronicë dhe dredhëza) pjesëmarrja e **CARITAS-it 50%, Komuna 35% dhe fermerët 15%.** Përfituesit e këtij donacioni janë **14 bletarë dhe 3 fermerë** të cilit merren me pemëtari.
**Bashkëpunimi me IADK-në:** Është ndërtuar një plantacion (menta, hithër) në hapësirë prej **0,20 Ha.**
**Bashkëpunimi me OJQ-të komunale:** Problemet dhe rreziqet që e bëjnë të pamundur funksionimin sipas vëzhgimit të liderëve, si dhe vëzhgimi i shërbimit që OJQ-të lokale veprojnë ashtu siç ata e gjykojnë të përshtatshme, ku nuk ka asnjë justifikim për ta, nuk kanë pasur aktivitete të veçanta në vitin e kaluar.
**Vizitat e qumshtoreve për grumbullimi dhe përpunimin e qumshtit:**
Organizimi cilësor i kapaciteteve blerëse dhe përpunuese, arriti standarde të mira, shprehu nevojë për pagesa të primeve të qumështit si subvencione nga ana e Ministrisë. Në krahasim me një vit më parë, qendrat e blerjes blenë gjashtë herë më shumë qumësht.
**Vizitat e fermerëve në pikat sezonale (verore):**
Problemet kanë mbetur të njëjta, mungesa e mbështetjes e kompetentëve, kushtet higjenike-sanitare të dobëta.
**Takimet dhe aktivitetet me bletarët:** Regjistrimi i bletarëve, janë indentifikuar problemet dhe roli i shoqatës dhe Drejtoratit për tejkalimin gjendjes aktuale (gjendja shëndetësore e bletëve). Në bazë të vërejtjeve të të gjithë bletarëve ka shqetësim për mbijetesë të këtijë komuniteti. Për këtë temë janë mbajtur 5 takime me bletarë.
**Bashkëpunimi dhe mbikëqyrja e të mbjellurave pranverore dhe vjeshtore:** Prill, Maj, Shtator-Tetor
**Organizimi dhe përcjellja e korrjeve:** Korrik-Shtator
**Hartimi dhe implementimi i projektit të Zhvillimit Rural:** Këtë vitë, asnjë projekt nuk është realizuar nga ana e MBPZHR-së për zhvillim rural.
**Pjesëmarrje në grupet punuese për planifikim:** Hartimi i programit zhvillimor të Komunës.
**Shqyrtimi dhe diskutimi rreth punës së drejtoratit:** Aktivitet punuese, problemet eventuale si dhe disciplina. Njësiti ka kryer punët administrative dhe teknike në baza ditore.

**Grantet e MBPZHR-së:** Nga komuna e Dragashit kanë përfituar Grant **4 fermerë.**

- Një stallë për blegtoriale;
- Dy fermerë bletarë
- Një punëtori për djathë

**Turizmi:** Në projektin e përbashkët të bashkëpunimit ndër-kufitar me Komunën e Gostivarit(Maqedoni) janë shtypur broshura, mapa truristike dhe libra për promovimin e turizimit në regjionin e "Maleve të Sharrit" të koumave të Dragashit dhe Gostivarit, të financuara nga Komisioni Evropian.

**Sektori i Inspeksioneve:**

1. Ky vite për shërbimin e inspeksionit ishte një nga vitet më aktive, inspeksioni punonte deri në orët e mbrëmjes së vonë në terren;
2. Janë rritur kontrollet e tregut dhe sanitare nëpër ndërmarrje rreth sigurisë dhe mbrojtjen shëndetësore të qytetarëve;
3. Lufta kundër uzurpimit të pronës shoqërore.
5. Gjendja vjetore e inspektimit për vitin 2019 është si vijon:

| Nr.rr. | Emri dhe mbiemri i Inspektorit Dhe emri i inspeksionit | Numri i kontrollimeve me procesverbal | Nr.i procesve me Vendim | Nr.i procesve pa Vendim | Numri i kërkesave për procedurë kundërvajtëse | Numri i licencave të lëshuara | Numri i ankesave të qytetarëve | Nr. i thirrjeve të paleve | Numri i inspektimeve me të tjerët / policia | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Enis Sylejmani Inspektori i tregut | 189 | 12 | 100 | 9 | 11 | / | 11 | 68 | 1164,75€ mall i larguar nga tregu |
| 2 | Sherafidin Osmani Inspektori sanitar | 82 | / | / | / | 11 | / | / | 68 | |
| 3 | Armend Piraj Inspektori komunal | 167 | 88 | 79 | 4 | / | 47 | 8 | 68 | |
| 4 | Vetim Hasani Inspektori i ndërtimit | 40 | 8 | 34 | / | / | 37 | / | 20 | |
| 5 | Refki Alija Inspektori i trafikut | 25 | 10 | 15 | / | / | 10 | 5 | 15 | |
| 6 | Vebi Nazifi Inspektori veterinar | 60 | / | / | / | / | / | / | 68 | |

**Sektori i Pylltarisë:**

- Është shpallur oferta përmes zyrës së prokurimit për shitjen e masës teknike në rajonet e planifikuara të komunës, kompania "Diti" nga Suhareka ka fituar tenderin, me të cilën u nënshkrua kontrata.
- Është përfunduar shitja e lirë e masës së drurit për qytetarët e komunës.
- Drejtoria ka realizuar aktivitete përtej kufijve të kompetencës së saj në parkun nacional "Sharri" bazuar në Memorandumin e Komunës së Dragashit dhe Ministrinë e Mjedisit për shkak të zyrtarëve të pamjaftueshëm të parkut për komunën tonë.

**<u>Shënim:</u>** <u>Është kryer pyllëzimi i **20 hekterëve për vitin 2019.**</u>

Gjendja e pylltarisë për vitin 2019 ka qenë si në vijim:

| Plani për prerjen e pyjeve për vitin 2019 | Prerje e realizuar e drurit | Prerje e parealizuar e drurit | Gjithsej ardhurat | Të ardhura nga ankandi publik | Të ardhura nga shitja e lirë | Të ardhura tjera | Të ardhurat nga fermat private | Të ardhurat nga materiali i thatë | Kompensimi i dëmit | Të ardhurat nga thupra dhe degë | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1.870.16 m3 | 1.671.42 m3 | 198.74 m3 | 33.901,90 € | 5.265,98 € | 26.798,65 € | % € | 180,72 € | 1.483,55 € | % € | 173,0 € | |

| Gjithësej dëmet | Numri i pylltarëve në kontroll | Gjithësej dëmet | | Shuma e arsyeshme e drurit | | Shuma e paarsyeshme e drurit | | Gjitësej kallëzime | | | | Konfiskuar | Vërejtje |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | m³ | € | m³ | € | m³ | € | Raport për kundërvajtje | kallëzime penale | m³ | € | Ndarë familjeve të dëshmorëve | |
| | 8 | 57,52 m³ | 791,83 € | 20,49 m³ | 2.398,23 € | 37,03 m³ | 1.006,40 € | % | 28 | 6.90 m³ | % m³ | % m³ | |

**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO**
**REPUBLIK OF KOSOVO**
**Kuvendi Komunal Dragash – Skupština Opštine Dragaš – Municipality of Dragash**
Drejtorati për Inspeksioni, Bujqësi, Pylltari, Turizëm dhe Zhvillimit Rural
Direktoriat za Inspekciju, Poljoprivredu, Turizam, Šumarstvo i Ruralni Razvoj
Directorate for Inspections, Agriculture, Tourism, Forestry and Rural Development

**Të nderuar!**

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutit të Komunës së Dragashit, drejtori i Drejtoratit për Inspeksion, Turizëm, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dërgon këtë Plan të Punës të Drejtoratit,për vitin 2020. Plani vjetor i Drejtoratit...përfshinë periudhën prej 03.01- 31.12.2020. Kuptimi i koncepteve për këtë Plan janë mjaft fleksibile me mundësi të përshtatjes së ndryshimeve të shkaktuara, harmonizimit kohor me lëvizje të vërteta dhe zhvillimin e Komunës së Dragashit.

Si qëllime kryesore të këtij Plani janë: përmirësimi i efikasitetit dhe funksionalitetit të Drejtoratit, kontaktet direkte dhe të përhershme me drejtoratet tjerë, ministritë përkatëse, partitë, institucionet ndërkombëtare dhe sigurimi i diciplinës në punë në atë nivel i cili mundëson kushte për punë ligjore të Drejtoratit.

Drejtorati gjatë kryerjes së punëve dhe detyrave të veta, aktivitetet e veta do t'i drejtojë në realizimin e detyrave të cilat nuk janë kryerë në vitin e kaluar 2019.

## SEKSIONI PËR BUJQËSI,TURIZËM DHE ZHVILLIM RURAL:

Siç dihet, dhe duke pasur parasysh se politika shtetrërore agrare definohet në MBPZHR, nuk ekzistonë kompetencë direkte shtetërore e Komunës lidhur me këtë, pos në pjesët lidhur me udhëheqjen e tokës ndërtimore. Por, ekziston nevoja evidente dhe dëshira që të sigurohet zhvillimi i bujqësisë në komunën tonë, për këtë Komuna dhe vetë Seksioni për Bujqësi të cilat janë më afër bujqëve ka rol të rëndësishëm në zhvillimin e bujëqësisë të orientuar në katër drejtime:

- **Krijimi i kushteve të volitshme për investime në bujqësi dhe përpunim,**
- **Përgatitjet për shfrytëzimin sa më të mirë të mjeteve të Miniastrisë, fondeve të BE-së apo donatorëve,**
- **Përmirësimi i kapaciteteve lokal të qeverisjes për t'u përgjigjur kompetencave që ka Komuna në mënyrë sa më cilësore,**
- **Sigurimi i përkrahjes direkte të bujqëve në kuadër të mundësive vetanake.**

**Bashkëpunimi me MBPZHR dhe Zyrën Rajonale:** Për çështjet e zhvillimit të projekteve, seminareve për çështjen e projekteve, seminarave për përkrahje, raportim, informata, lajmërime, ndihma fermerëve për projektet e programeve të subvencioneve të ndryshme, granteve dhe premive.

**Subvencionet dhe grantet:**

- Pjesëmarrja aktive e shërbimeve për projektet e subvencioneve të mjeteve të grantit për prodhimtari bujqësore, njoftimi me kriteret për aplikim të cilat i rekomandon MBPZHR.
- Përpunimi dhe kontrollimi i mbjelljeve dhe korrjeve:
  a. Mbjeljet dhe korrjet pranëverore,Prill-Maj,
  b. Mbjelljet dhe korrjet vjeshtore,Shtator-Tetor,
  c. Raportet t'i dërgohen MBPZHR.

**Bashkëpunimi me donatorët:** Me investitime vendore dhe të jashtëme do të punohet për zhvillimin e Bujqësisë në Parkun Nacional "Sharri" lidhur me realizimin e projekteve të Komunës dhe drejtoratit në kufi të parkut për ndihëma në bujqësi për hartimin e kontratave për shfrytëzimin e kullotave të larta për kullotje sezonale në kuadër të Parkut Nacional "Sharri",si dhe kërkesa nga udhëheqësia e Parkut nacional për hartimin e kontratave me fermerë për tokën e punushme bujqësore për nevojat e mbjelljeve dhe sigurimi i ushqimit për kafshë për fermat ekzistuese, si dhe për qëllime komerciale.
**Bashkëpunimi me kooperativat, fermerët dhe gupe fermerësh:** Çdo muaj këshillime profesionale, trajnime për promovim më të mirë të prodhimeve me theks të vaçantë në prodhimtari blegëtorale. Në kërkesa, probleme dhe nevoja të fermerëve të gjenden zgjidhje të pranueshme.Vizitat e qumshtoreve dhe pikave grumbulluese në komunën tonë.
**Bashkëpunimi me FAO-në, UNDP-në dhe CARITAS-in:** Shumica e organizatave ndërkombëtare e kanë përfunduar programin për Komunën e Dragashit dhe Komuna do të shqyrton mundësitë e vazhdimit të bashkëpunimit me FAO-në, GIZ-in, UNDP-në dhe Caritas-in përmes aktiviteteteve në zhvillimin e bujqësisë dhe cicëronit turistik për zhvillim të komunës së Dragashit.
**Organizimi i panaireve dhe ekspozitave bujqësore:**

- Në ekspozitën dhe panairin e Prillit, ekspozita e kafshëve: lopë mjelëse, mëshqerra, demave, deleve, dhive dhe kafshë tjera.
- Ekspozita dhe panairi i Tetorit të lopëve mjelëse,mëshqerrave, demave,deleve, dhive dhe kafshëve tjera. Prodhime bujqësore: qumësht, djathë, mish, mjalt, bimë mjekuese dhe prodhime ekzotike,
- Mundësimi i pjesëmarrjes së fermerëve tonë në panaire tjera të Republikës Kosovës.

**Mbajtje të takimeve me bletarë:** Vizita, këshillime për mundësinë e organizimit të seminareve dhe trajnimeve për zhvilimin e bletarisë.
**Bashkëpunimi me LGR Bio – Šari:** Hartimi dhe implementimi i projektit për zhvillim rural.
**Bashkëpunimi me organizatat e jashtme qeveritare: UNDP, TIKA, USAID, GIZ, ICO dhe IOM:** të zhvillohen lidhjet e mira, të hartohen projekte të reja dhe të implementohen, dhe të ripërtrihen mardhëniet me ato organizata ku janë shkëputur lidhjet.
**Të hartohen projekte ideore:** Për donatorët potencial, me pjesëmarrjen e Komunës, për fillim të ndërtohet hapësira ekspozuese në lokalitete në të cilët do të ekspozohen prodhimet autokton dhe manifestimet karakteristike me tipare gjeografike dhe tenike.
**Vizita ambasadave të huaja:** Përfaqësimii komunës sonë, reklamimi i bjeshkëve, prodhimeve tona bujqësore, të kërkohen ambasada që të na organizojnë dhe gjejnë komuna për vëllazërime.Pra,komuna të ngjajshme si e jona për zhvillim të blegëtorisë, bujqësisë dhe turizmit, kërkmi i investimit të shteteve dhe organizatave të tyre.
**Azhurimi i web-faqes së Komunës:** Linku i Drejtoratit në web-faqen të hartohet si faqe për botën Globale. Të vendosen të gjitha shënimet për të gjitha resurset me fotografi,si dhe ngjarjet në Drejtorat,si dhe të shpallen të gjitha lajmërimet,konkurset dhe kërkesat.

## INSPEKSIONI

Detyrë themelore për Inspeksioninin është të kontrollohen të gjitha veprimtaritë,në mënyrë që qytetarëve t'u mundësohet shërbime të shëndosha dhe efikase,mbrojtjen e konsumatorëve dhe t'u dilet në ndihmë konsumatorëve,si dhe bashkëpunimi me drejtoratet tjera në aspektin e asistencës.

**Inspeksioni i tregut:**

-Mbikqyrje,të zbatohet Ligji për Inspeksionin e Tregut sipas nenit 6: për Tregtin e Brendshme, Ligjin për Konsumatorët, Ligjin për Njësitë Matëse,si dhe dispozita përkatëse të parapara me ligjin të cilat i referohen Inspeksionit të Tregut,

-Vizita dhe kontrolli i prodhimeve: subjekteve afariste në terrenin e Komunës së Dragashit,

-Lufta kundër ekonomisë joligjore:

-Ofrimi ndihmës profesionale: subjekteve afariste për eliminimin e parregullësive me rastin e ushtrimit të veprimtarive afariste,

-Regjistrimi dhe liçencimi: identifikimi i subjekteve të paregjistruara afariste në Komunën e Dragashit,

-Njoftimi i subjekteve afarist: për iniciajtivat e reja, sugjerimet dhe propozimet në sferën e isnpekcionit të tregut,në zhvillimine hovshëm të teknologjisë,ekonomisë dhe biznesit në tërësi lidhur me informimin me ligjet e reja me Inspektorin Sanitar,Inspektorine Punës dhe inspektorët tjerë,

-Kërkesat: shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

**Inspeksioni Sanitar:**

-Zbatimi i Ligjit: për Inspeksionin sanitar,

-Mbikqyrja e mallërave dhe prodhimeve: mbikqyrja sanitare dhe shëndetësore,pastaj mbikqyrja e personelit që merren me prodhimtarinë e çfardo prodhimi,

-Vizita dhe kontrolli i prodhimeve: objekteve hoteliere, prodhimeve dhe ushqimit,

-Kontrolli i objekteve për ujë të pijes: bazenëve publik dhe privat të ujit, rrjetit të ujit

-Dhënia e pëlqimeve: për objektet hoteliere,të kyçen pas licencimit,

-Njoftim me subjektet afariste: për iniciativat e reja, sugjerimeve dhe propozimeve në sferën e Inspeksionit Sanitar, Inspeksionin e Tregut, Inspeksionin Komunal dhe Inspeksionin e Veterinarisë,

-Kërkesat: shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

**Inspeksioni Veteriner:**

-Zbatimi i Ligjit: për Inspeksionin e Veterinarisë,

-Mbikëqyrja e objekteve të mallërave dhe prodhimeve: mishit,prodhimeve të mishit,qumështit dhe prodhimeve të tij me Inspektorin Sanitar,

-Kontrolli: prodhimeve të bagëtisë,

-Mbikëqyrja:shëndetësia ebagëtisë dhe mbikëqyrja,si dhe pengimi i përhapjes së epidemive,

-Kërkesat: shqyrtimi i kërkesave dhe nevojat e qytetarëve.

**Inspeksioni i Çështjeve Komunale:**

-Zbatimi i ligjit dhe rregulloreve: për rend publikë, në të mirë të popullit,

-Mbrojtja e ambientit: nga ndotja përmes veprimeve të ndryshme nga ana e popullatës dhe ndërmarrjeve,

-Kontolli dhe menaxhimi: hapësirave publike,ujësjellësëve dhe kanalizimeve,

-Kontrolli: subjekteve afariste në terren me inspektorët tjerë,

-Kërkesat: shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

**Inspeksioni i Ndërtimtarisë:**

-Zbatimi i Ligjit dhe rregulloreve: ndërtimi në tërë teritorin e komunës së Dragashit.

-Kontrolli: i objekteve për marrjen e lejeve për ndërtim,grupeve të mjeshtërëve se a kanë ndërmarrje të regjistruara,

-Komisioni: pranë Komisonit Komunal për vlerësimin e tenderëve,

-Të mbrohet: pasuria shoqërore dhe pengimi i uzurpimit të rrugëve publike dhe ndërtimeve që bëhen në to,

-Kërkesat: shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

**Inspeksioni Komunikacionit:**

-Zbatimi i Ligjit dhe rregulloreve:për komunikacionin, për udhëtim të sigurt të qytetarëve dhe siguria në rrugë,

-Njoftimet: të qytetarëve dhe shoferëveme informata të reja teknike,

-Kontrolli: të gjitha llojet e automjeteve , transportuese ,të udhëtimit,verifikimi i regjistrimeve, kontrollit teknik, të paisjeve dhe pjesëve rezervë, të përcillet se a zbatohet paisja verore e dimërore e gomave etj..,

-Liçenca: me vetura ekonomike, taksistëve t'u jepet liçenca për punë,

-Regullimi: rregullimi i komunikacionit për vozitje të sigurt,si për vozitës dhe të tjerët,

-Bashkëpunimi: me inspeksionet tjera dhe Shërbimin Policor të Kosovës,

-Kërkesat: shqyrtimi i kërkesave dhe nevojave të qytetarëve.

## PYLLTARIA

**Plani i menaxhimit të pyjeve, për vitin 2020 është, si vijon:**

-Realizimi i Planit të APK-së për vitin 2020,

-Rregullimi parakomercial dhe planifikim të prerjes së pyjeve,

-Bërja e ankandit me zyrën e prokurimit,

-Ekzekutimi i shitjes së masës drurore, për vitin 2020,

-Mbrojtja e pyjeve dhe drurëve, dhe kryerja e kontrolleve të planifkuara,

-Rauajtja dhe mbrojtja e pyjeve nga zjarret dhe çështjeve tjera të padëshiruara,

-Kontrolli i shoqatave të gjahtarëve për zbatimin e Planit të Menaxhimit të Gjahut

-Pyllëzimi i planifikuar rreth 20 hektarë.

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

# R A P O R T

**I PUNËS SË DREJTORATIT TË URBANIZMIT, KADASTRIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT, për vitin 2019 & Planin e Punës, për vitin 2020**

**Drejtori: Bean Haxhihasan**

**Dragash,________2020**

Republika e Kosoves
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komunes Dragash
Opština Dragaš
Municipal Dragas

**Drejtorati per urbanizem,kadaster dhe mbrojtje te mjedisit**
**Direktorijat za urbanizam,katastar i zaštitu sredine**
**Directorate for urbanism,cadastre and environment protection**

--

| | |
|---|---|
| **DATE/A:** | **11.02.2020.godine** |
| **REFERENCE-E:** | **06.br.** |
| **PER/ZA/TO:** | **Predsednika Opštine Dragaš,g.Šaban Šabani** |
| **CC:** | |
| **PERMES/PREKO/THROUGH:** | **Skupštinska služba prevođenja g-dina Suad Tosuni/Hazbi Halili** |
| **NGA/OD/FROM:** | **Direktora DUKZS-e,Bean Hadžiasan.............................................** |
| **TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:** | **IZVEŠTAJ O RADU ZA 2019.GODINU** |

**Të nderuar,**
Duke u nisur nga detyrat specifike të përfshira në Planin e Punës për vitin 2019, Ligjit në fuqi, Udhëzimet Administrative dhe instruksione të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Agjencisë Kadastrale të Kosovës, Statuti i Komunës së Dragashit, Vendimi i Kryetarit të Komunës, Vendimi i KK të Dragashit dhe aktivitetet bazë të Drejtorisë , u zhvillua gjatë vitit 2019 si vijon:

## I. Sektori i urbanizmit dhe planifikimit hapësinor:

**Procedura administrative**:
Në bazë të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Ligji Nr. 05 / L-031), Ligjin për Planifikimin Hapësinor, Ligjin për Ndërtim dhe Udhëzimet Administrative për zbatimin e ligjeve të lartpërmendura, Sektori i Urbanizmit dhe Planifikim Hapësinor është përgjigjur si në vijim:

Paraqitja tabelare: Lejet për ndërtim për vitin 2019 **(Ligji për Ndërtim, Ligji Nr. 04 / L-110 dhe UA MMPH Nr.06 / 2017 për përcaktimin e procedurës për dorëzimin dhe rishikimin e kërkesave për kushtet e ndërtimit, lejet e ndërtimit dhe lejet për shkatërrim për ndërtimet e kategorisë I dhe II)**

| Nr. | Leje të ndërtimit | Parcela urbane | Kërkesa të ndryshme | Kushtet ndërtimtaro-teknike |
|---|---|---|---|---|
| 1. | 5 | 24 | 45 | 19 |
| Gjithsej | 5 | 24 | 45 | 19 |

Shumë pak leje ndërtimi vazhdojnë të jenë si trend çdo vitë. Arsyeja për këtë është zbatimi i dobët i Ligjit për Ndërtim (Ligji Nr. 04 / L-110) dhe UA MMPH nr.06 / 2017, ku i gjithë kontrolli ndërtimor është në kompetencë të Inspektorit të Ndërtimit.

Duke krahasuar vitin 2018 me vitin 2019, vazhdon trendi i zvogëlimit të kërkesave për leje ndërtimi, të cilat pasqyrohen në një numër shumë të vogël të lëshuarve. Në bazë të Rregullores, kërkohet një angazhim i madhë i Drejtoratit të Inspekcionit-Inspektcionit të ndërtimit për të parandaluar trendin e mos aplikimit për leje ndërtimi.

Sektori i Urbanizmit ka marrë pjesë në legalizimin e ndërtesave pa leje ndërtimi, dhe ky proces është zbatuar në bazë të Ligjit, dhe deri më tani drejtoria përkatëse ka pasur rreth 15 kërkesa për legalizimin e atyre ndërtesave.
Drejtoria përkatëse është në koordinim të vazhdueshëm me Ministrinë në zbatimin dhe legalizimin e objekteve pa leje.

Gjatë vitit buxhetor 2019, Departamenti i Urbanizmit ishte i përfshirë në mënyrë aktive në komisione dhe organe tjera të cilat i formon Kryetari i Komunës. Ato punë janë kryesisht organ mbikqyrës dhe komision pranues, si dhe komision per vlerësimin e tenderit.

## II. Sektori i Mbrojtjes së Mjedisit:

Gjatë vitit 2018, Zyrtari për ambient ka pasur në këto detyra:

- Mbikëqyrja e gjendjes së mjedisit,
- Mbikëqyrja inspektoriale e gjendjes së mjedisit,
- Koordinimi i punëve me Ministrinë përkatëse,
- Puna për lëshimin e lejeve të mbrojtjes së mjedisit bazuar në Udhëzimin Administrativ për lëshimin e lejes mjedisore dhe gjatë vitit ka zgjidhur pozitivisht 3 kërkesa ku u është përgjigjur pozitivisht

---

## III. Zyra Kadastrale Komunale ZKK

Në bazë të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative, Ligjit për Kadastër, Ligjit për themelimin e regjistrit për të drejtat regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Udhëzimit Administrativ dhe instruksionet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës AKK, Zyra Kadastrale Komunale në Dragash ka reaguar pozitivisht në:

**Paraqitja tabelare:I**

| Nr. | Emërtimi i vendimit | Kërkesat e pranuara | Kërkesat e miratuara | Kërkesat e refuzuara | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Për transferim të pronës<br>-Trashëgim,<br>-shitëblerja,<br>-dhuratë,<br>-ndërrim,<br>-vendimet gjyqësore,<br>-vendimet administrative,<br>-regjistrim në bazë të kontratës së agjencisë së besimit të Kosovës,<br>-modifikimi | **366** | **366** | **0** | |
| 2. | Shërbimet e kadastrit:<br>-ndarja e parcelave,<br>-bashkimi i parcelave,<br>-kufizimi i parcelave,<br>-dhe shërbimet tjera | **67** | **67** | **0** | **67** |
| 4. | Gjithsej | **433** | **433** | **0** | **433** |

**Paraqitja tabelare:II**

| Br. | Emërtimi i shërbimit | Kërkesa të pranuara | Kërkesa të miratuara | Kërkesa të refuzuara | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Lëshim të:<br>-çertifikata të palujtshmërisë<br>-kopije të planeve A4, me koordinata<br>-Vërtetim që nuk posedon palujtshmëri (për ushtrimin e të drejtave të qytetarëve) | **1547** | **1547** | **0** | **1547** |
| 2. | Gjithsej | **1547** | **1547** | **0** | **1547** |

Duke krahasuar vitin 2018 me vitin 2019, ka pasur zvogëlim, kërkesa të zgjidhura dhe vendime të lëshuara për transferimin e pronës, në bazë të punës ligjore dhe vendimeve gjyqësore, plani për vitin 2019 nuk është përmbushur nga këndvështrimi i vendimeve të pranuara dhe të miratuara, por sa i përket mjeteve të grumbulluara, atz është tejkaluar për rreth 7000.00€, sepse mjetet e grumbulluara për vitin 2018 janë **35 531.00€, përderisa për vitin 2019 janë 42 522.00€.**
Në bazë të Udhëzimit Administrativ (VRK) -nr.04 / 2017 për ndryshimet dhe plotësimet e UA (VRK) -nr.03 / 2016 për masat e veçanta për regjistrimin e pronës së përbashkët në emër të dy bashkëshortëve, janë regjistruar 0 kërkesa, pasi ende bashkëshortët nuk mund të vendosin, edhe pse udhëzimi administrativ ofron një sërë përfitimesh.

Agjencia Kadastrale e Kosovës ka miratuar gjashtë rregullore të reja administrative për zbatimin e Ligjit për Kadastrën, dhe risia e këtyre rregulloreve administrative është se zyrtarët e ZKK-së (gjeodetëve) nuk do të kryejnë më bashkimin, ndarjen dhe kufizimin e parcelës; të gjitha këto punë do ti kryejë agjencioni kadastral i Kosovës në Prishtinë.
Detyrat që duhet të kryhen nga zyrtarët e ZKK-Gjeometër janë vetëm për qëllime të vetë Komunës.

- Zyrtari për sistem të adresave ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh në bashkëpunim me Agjencinë Kadastrale të Kosovës KKA
- Zyrtari për sistem të adresave ndërmerr një sërë aktivitetesh nga KKA për përditësim të adresave të sistemit.

---

## IV. Sektori i shërbimeve pronësore-juridike

Shërbimi pronësoro-juridik, funksionon në kuadër të Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, dhe në bazë të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative të Ligjit për shpronësim të Tokës, Ligjit mbi vetëpërfshirjen e pronës shoqërore, Udhëzimeve Administrative, vendimit të Kryetarit dhe vendimit të Kuvendit Komunal të Dragashit ka kryerë detyrat e mëposhtme:

**Paraqitja Tabelare I.**

| Kërkesat e pranuara gjatë vitit 2019 | Uzurpimi i pronës shoqërore për vitin 2019 | Kërkesat e pronarëve për kompensim në lidhje me shpronësimin | Kërkesat për pjesëmarrje në ankand publik | Kërkesat për verifikim të dokumentacionit | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|
| Kërkesat e pranuar | 15 | 1 | 1 | 0 | 14 |
| Kërkesat e miratuara | 12 | 1 | 1 | 0 | 13 |
| Në procesë | 3 | 0 | 0 | 0 | 3 |
| Gjithsej | 15 | 1 | 1 | 0 | 30 |

Republika e Kosoves
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Skupstina Opština Dragaš Kuvendi Komunal Dragash

**Drejtorati për urbanizëm, kadastër dhe mbrojtje të mjedisit**
**Direktorijat za urbanizam, katastar i zaštitu sredine**
**Directorate for urbanism, cadastre and environment protection**

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, Dragashit dhe Vendimit të Kryetarit të Komunës së Dragashit, dhe ligjeve në fuqi që veprojnë brenda Drejtoratit përkatës, paraqesin planin e mëposhtëm të punës të Drejtorisë në fjalë për vitin e ardhshëm 2019.
Plani vjetor i punës së Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit mbulon periudhën nga 01.01.2020. deri më 31.12.2020. Koncepti i këtij plani duhet të kuptohet vetëm si një kornizë me një aftësi mjaft fleksibile dhe dinamike për t'u përshtatur me ndryshimet dhe përafrimin në kohë të planit me zhvillimet aktuale dhe zhvillimin e komunës së Dragashit.

Si qëllime më të rëndësishme të këtij plani janë:

1. Përmirësimi i efikasitetit dhe funksionalitetit të Drejtorisë dhe zvogëlimi i burokracisë dhe respektimi i afateve ligjore gjatë vendosjes sipas kërkesës ose sipas detyrës zyrtare.
2. Kontakte dhe bashkëpunime të vazhdueshme dhe cilësore me Drejtoritë, palët, ministritë, organizatat ndërkombëtare.
3. Sigurimi i disiplinës së punës në një nivel që siguron kushtet për funksionimin e duhur të Drejtorisë.
4. Bashkëpunimi me Drejtorinë e Inspekcionit - Inspektori i Ndërtimit, për të rritur kërkesat për marrjen e lejeve të ndërtimit të gjitha në bazë të Ligjit për Ndërtim dhe Udhëzim Administrativ.
5. Digjitalizimi i plotë i ZKK-Dragash, dhe implementimi i sistemit KOOPOS.
6. Qëllimet e tjera

Në kryerjen e punëve dhe detyrave të saj, Drejtoria do të drejtojë veprimtarinë e saj drejt realizimit të detyrave që nuk kanë përfunduar në vitin e kaluar 2019, që është zhvillimi i planeve zhvillimore dhe urbanistike për territorin e komunës sonë dhe hartat zonale të Komunës, që paraqet detyrim ligjor të komunës sonë.

Prioritete të rëndësishme këtë vit janë:
- legalizimi i ndërtimeve pa leje, sipas ligjit që merret me këtë çështje, i cili u miratua në Kuvendin e R.Kosovës;
- përfundimi i dixhitalizimit të kadastrës së pasurive të patundshme dhe rrjetit kadastral;
- realizim efikas dhe në kohë i projekteve të infrastrukturës në kuadër të investimeve kapitale, buxhetit fiskal për vitin 2020 dhe donacioneve nga burime të ndryshme;
- Hartimi dhe miratimi i rregullave për funksionimin efikas të Drejtorisë, bërë nga Asociacioni i Komunave të Kosovës.

Punët e rregullta:

- Procedura administrative dhe puna me klientëtË
- Aktivitetet për mbrojtje mjedisore;
- lëshimi i lejeve të ndërtimit dhe kushteve teknike për ndërtim;
- ofrimin e ndihmës teknike për drejtoritë e tjera;
- pjesëmarrja në Bordin e Drejtorëve;
- përgatitja e raporteve dhe planeve të punës;
- dhe detyra të tjera të rregullta bazuar në ligjin në fuqi.

Me rrespekt!

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

# RAPORT

**I PUNËS SË DREJTORATIT TË MBROJTJES, SHPËTIMIT DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE, për vitin 2019 & Planin e Punës, për vitin 2020**

**Drejtori: Mursel Halili**

**Dragash,________2020**

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash / Skupština Opštine Dragaš / Dragas Municipality
Drejtorija për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike
Direktorijat za Odbranu, Spašavanje i Javne Usluge

| | |
|---|---|
| DATE/A: | 13.01.2020 |
| REFERENCE-E: | 08-020/01-957/20 |
| PER/ZA/TO: | Kuvendit Komunal DRAGASH |
| PERMES/PREKO/THROUGH: | Zyrja e pranimit |
| NGA/OD/FROM: | Drejtorija për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike<br>Drejtor, Murselj Haljilji ______________ |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Raporti i punës për vitin 2019 |

## RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2019

Aktivitete të ndërmarrura Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike për vitin 2019 bazohën kryesishtë në Planin e aktivitetëve për vitin 2019, si dhe në bazë të rrethonave dhe evenimenteve të cilët kanë ndodhur gjatë vitit.

Drejtorija për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, detyrat dhe obligimet të veta të planifikuara pë vitin 2019 e ka realizuar nëpërmjet sektoreve te drejtorisë, të bashkangjitur në shtojcë:
Shtojca e dokumentit:

Shtojca: Raporti i Njësisë profesionale e zjarrfikjes dhe shpëtimit
Shtojca: Raporti i punës së zyrtarit për shërbime publike
Shtojca: Raporti i punës së zyrtarit për ndërlidhje
Shtojca: Raporti i punës së zyrtarit për mbeturina

## NJËSITI PROFESIONAL I ZJARRFIKJES DHE SHPËTIMIT

Njësiti profesioanl i Zjarrfikjes dhe Shpëtimit i komunës së Dragashit, në kuadër të aktiviteteve të shumta nga fushëveprimtaria e vet, konform Ligjit dhe dokumenteve relevante, ka krye me sukses obligimet e veta dhe misionin për mbrojtjen e jetës së njerëzve, të mirave materiale dhe pasurisë së qytetarëve. Natyrisht se jemi ballafaqua me sfida të shumta, për çdo ditë, por suksesi nuk ka mungua. Kjo, falë angazhimit të njësitit, i cili edhe me numër të pamjaftueshëm të personelit, ka tregua rezultate pozitive. Angazhimi do të vazhdoj edhe më tej dhe jemi të gatshëm të ballafaqohemi me sfida që presin Njësitin. Në bazë të statistikave për vitin që lam pas, vërtetohet se masat dhe aktivitetet e ndërmarra kanë dhënë rezultate pozitive dhe dukshëm është zvoglua numri i daljeve për intervenime nga Shërbimi.

Një prej vështirësive të theksuara që na ka shkaktua probleme dhe ngecje në veprimtari të mirëfillt, padyshim ësht vëndosja e hidrantëve nëpër fshatra, aktivitet i cili ende nuk po gjen përkrahje dhe pamundëson intervenim të shpejtë dhe efikas. Kjo për arsye se qendra e Dragashit është largë nga disa fshatra edhe deri në 20 km që pamundëson intervenim të shpejtë dhe efikas.

Duhet të theksohet fakti shumë i arsyeshëm dhe i rëndësishëm për kryerjen e obligimeve të njësitit e që është mungesa e kuadrit zjarrfikës nga se në situatat kur kemi intervenime më serioze, është i pamjaftueshëm angazhimi i mirëfilltë, sidomos kur ndonjëri nga zjarrëfiksit është në pushim mjekësor, vjetor ose mungon për ndonjë arsye tjetër, shkakton çrregullime në aktivizimin e Njësitit në intervenim, kur Shërbim në momente ka 2 persona. Shtrohet pyetja, kush do të komandon, kush do të vozis, kush do të fik zjarrin, kush do të kujdestaroj në objekt? Ne e dijmë se po bëhen përpjekje të subjekteve relevante për të gjet zgjidhje cilësore, por...

### Zjarrëvënjet

Një prej dukurive me të cilat Shërbimi Zjarrfikës ballafaqohet shumë shpesh, janë zjarrëvënjet të cilat po shkaktojnë dëme të mëdha. Si masë e obligueshme, për ndërprejen, mundësisht dhe minimizimin, Shërbimi ka ndërmarrë masa parandaluese: senzibilizimi i popullatës për dëmet që skaktojnë zjarret, ligjërata nga imamet në xhamitë e komunës, bashkëbisedimet me shoqata, shoqëri dhe interesent tjerë, shkolla, bashkësi tjera, bashkëpunimi i ngusht me Policinë e Kosovës, Shërbimi i pylltarisë.

Gjithashtu, shërbimi ka intensifikua aktivitete direkte me automjete në vëzhgimin e terrenit, ku për çdo ditë mjetet e terrenit kanë vëzhguar në tërë territorin e komunës dhe kanë pamundësua që dëmtuesit të kryejnë punët e tyre të liga të zjarrëvënjeve te qëlllimshme. Gjithsesi se është harxhua më shumë karburant, por janë zvoglua dukshëm dëmet në shfarosjen e pyjeve, vlera e të cilave është e pallogaritshme.

Zonat, ku më së tepërmi ka intervenime të Njësitit Profesional të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit të cilat vrojtohen me shumë kujdes, por jane:

Koritniku, Malet e Zymit, Fusha e Dragashit, Plavës, Buqës, Breznës, Kukajanit, Brrutit, Orçushës, Mejdani i Buzezit, Llopushniku dhe bjeshkët në përgjithësi. Janë vizituar deponitë legale dhe ilegale dhe po kërkohen mundësi( pasi që situata është alarmante mbi gjendjen momentale) të tejkalohet gjendja. Janë organizuar edhe punëtori nga OSBE dhe është debatuar mbi Ekoregjionin dhe Hidroregjionin si të funksionalizohen në mënyrë sa më efikase.

Struktura e intervenimeve të Njësitit Profesional të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në vitin 2019 është si vijon:

| Nr | Lloji i intervenimeve | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Korrik | Gusht | Shtator | Tetor | Nentor | Dhjetor | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Zjarre | 14 | 13 | 41 | 2 | 2 | 4 | 6 | 3 | 13 | 13 | 2 | 2 | 115 |
| 2. | Intervenime teknike | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2 |
| 3. | Sherbime | 4 | 4 | 1 | 3 | 3 | 6 | 6 | 12 | 4 | 3 | 2 | 2 | 50 |
| 4. | Aksidente komunikacioni | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 1 | 2 | 0 | 4 |
| **Total** | | **18** | **17** | **42** | **5** | **5** | **10** | **13** | **17** | **17** | **17** | **6** | **4** | **171** |

Vlenë të theksohet se K-danti dhe zv. K-danti, gjatë sezonit pranverë- vjeshtë e vonë, për çdo ditë kanë bërë vëzhgime permanente nëpër tërë terrenin e komunës së Dragashit, duke treguar me prezencë dhe aktivitet se terreni po vëzhgohet dhe zjarrëvënësve të u bëhet me dije se dikush po i përcjell. Kjo ka dhënë rezultate të dukshme dhe pozitive që tregon uljen e përqindjes së intervenimeve gjatë vitit kalendarik.

Mund të nxirret si konkludim në bazë të përvojës së zjarreve të shumta gjatë sezonit veror, se duhet më shumë angazhim të strukturave komunale, subjekteve tjera t;Sigurisë, Bizneseve, Shoqatave dhe Shoqërive dhe qytetarëve, për çasje më serioze problemit të pasurive të veçanta nga se humbjet janë katastrofale e rimëkëmbja gati është e pamundur. Apelojmë të mos kursehet vullneti, forca dhe paraja për menaxhim më të mirë të kësaj problematike.

Shërbimi është i gatshëm të ofroj ndihmë të duhur për të interesuarit kurset profesionale mundësojnë që shërbyesit me aftësitë e veta bartin përvoja pozitive tek qytetarët dhe u mundësojnë të marrin njohuri fillestare dhe shumë të dobishme mbi zjarrëvënjet dhe dukuritë tjera negative të sigurisë së pronës, njerëzve dhe të mirave materiale dhe do të ishte kontribut i qytetarit të minimizojnë dëmet ose ti parandalojnë ato. Shërbimi në çdo kohë ofron mundësi bashkëpunimi, andaj apelojmë të paraqiten për konsultime dhe aktivitete që u interesojnë në lëmin e zjarrfikjes, shpëtimit dhe aktivitete të ngjajshme për mbrojtjen e jetës, pasurisë dhe të mirave materiale.

Posacerisht apelojmë te barinjtë nëpër kullota në bjeshkë, banorët e Shqipërisë që gravitojnë rreth kufirit (duke mbledhur fryte të ndryshme nëpër bjeshkë) të mos dëmtojne florën dhe faunën (ose duke dhezur zjarre, ose dëmtime fizike të shkurreve dhe bimëve tjera) nga se edhe mundësia e intervenimit të Njësitit Zjarrëfikës në bjeshkë gati është e pamundur. Kërkojmë që të krijohen korridore nëpër male me drunj të shpesh për lëvizje më të lirë me automjete nga se mundësohet lëvizje më e shpejtë dhe e kontolluar dhe situata bëhet me e qartë. Ne po përballemi me kushte të dobëta sa i përket furnizimit me paisje, aparaturë dhe automjete, andaj çdo ndihmë e subjekeve relevante që mund të ndihmojnë, do të jet me interes jetik.

Qeveria e Kosovës dhe AME me furnizim me nga një kamion IVECO me të cilin po kryhen shumë punë dhe është investim kapital për komunën ton, ka bë punë të madhe dhe në të ardhmen ne presim bashkëpunim të vazhdueshëm dhe permanent.

Ne kemi percaktuar zonat më të rrezikshme në të cilat zjarret e përmasave të mëdha do të shkaktonin dëme të konsiderueshme, andaj kemi informuar me kohë te gjitha subjektet relevante që merren me problematikën e sigurisë së përgjithshme që në kuadër të angazhimeve të veta, kujdes të posçëm ti kushtojnë problematikës së zjarreve. Kemi apeluar në strukturat udhëheqëse të komunës që të ndërmarrin masa, aktivitete dhe veprime konkrete që do të mundësonin që Njësiti dhe pjesemarrësit tjerë në shuarjen e zjarreve të mos ken pengesa gjatë intervenimeve .

Kuvendit komunal, Asamblesë, Drejtorive dhe institucioneve të rëndësishme dhe Bizneseve u kemi bërë me dije se duhet të angazhohen seriozisht si në ofrimin e ndihmës për Njësitin Zjarrfikës si dhe me ndërmarrjen e masave për të dhënë mundësi Njësitit të angazhohet më me sukses. Ne po hasim në pengesa sa i përket komunikimit të mirëfillt me organet komunale, andaj apelojmë te Ju të gjeni mundësi ti ,sugjeroni për rëndesinë e bashkëpinimit të mirëfilltë.

Gjithashtu, Ju lusim të kontaktoni më shpesh Njësitet, me vizita të drejtpërdrejta (edhepse jeni shumë të zënë), të gjeni mundësi të takimeve më të shpeshta me qëllim të bashkëpunimit.

Nëse bëhemi te pavarur, në kuader të MPB, Ju lusim të vizitoni më shpesh Nëesitet dhe të njiheni për së afërmi me problematikën e zjarrfikjes dhe shpëtimit. Gjithashtu, problem ne vete, paraqet edhe mosha e zjarrfikësave dhe duhet të ndërmerret sa më shpejtë diçka për të siguruar kuadër të ri dhe profesional. Mendojmë se komuna duhet ta vendos në prioritet punën e zjarrfikjes dhe shpëtimit nga se funksionimi komplet do të mundësonte të perballemi me më lehtësi me dukuritë e zjarrëvenjeve, keqpërdorimeve dhe mosrespektim të dispozitave ligjore nga ana e keqëbëresve.

Drejtorati ka kryer edhe detyra dhe obligime tjera, në planifikimin, organizimin dhe rregullimin e strukturave ekzistuese në kuadër të Drejtoratit.

Dragash, Dhjetor 2019.

Komandanti i NJPZSH: Fari Piraj

**RAPORTI**

**mbi punën e Zyrtarit të Shërbimit Publik për vitin 2019**

Në bazë të përshkrimeve të punës të parashikuara për zyrtarin e shërbimit publik dhe nevojën e drejtorisë, unë i realizova aktivitetet e mia në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së jetës njerëzore, pronës dhe mjedisit në vazhdimisht dhe në varësi të situatave me të cilat ballafaqohemi ndër vite.

Kam punuar në përgatitjen e raportit të përgjithshëm vjetor të Drejtorisë për vitin 2018 si dhe në përgatitjen, organizimin dhe zhvillimin e planit të punës së Drejtorisë për vitin 2019 në bashkëpunim me punonjësit e tjerë të Drejtorisë si dhe Drejtorin.

Përcaktoj përparësitë dhe detyrat bazuar në politikën e zhvillimit të komunës.

Në bashkëpunim me Drejtorin, kemi mbajtur komunikimin me shërbimet përkatëse në drejtim të koordinimit të aktiviteteve dhe harmonizimit të aktiviteteve, si dhe përpjekje për të harmonizuar planet me Drejtorinë e Planifikimit Urban për ndërtimin e mureve mbrojtës në të gjitha vendet ku ekziston rreziku i rrëshqitjes së rrëshqitjeve të tokës, si dhe mureve dhe kanaleve të mbrojtjes nga përmbytja ku kemi pasur rrëshqitje aktive.

Po ashtu, kemi bashkëpunim me kompanitë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve publike në komunën tonë, përkatësisht kompaninë "Drini" përgjegjëse me kontratë me komunën për mirëmbajtjen e verore dhe dimrore të rrugëve lokale, kompanisë "Ekoregjioni" e cila është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave me qëllim të përmirësimit të këtyre shërbimeve dhe ndërmarrjës " Hidroregjioni" për furnizimin me ujë dhe kanalizimet e komunës Dragash.

Në muajin qershor, morra pjesë bashkë drejtorin në takim me përfaqësues të JICA.

Kam marrë pjesë gjithashtu në një takim të Asociacionit të Komunave të Kosovës në Prishtinë për një propozim për ndryshimin e Ligjit të Ujërat të Kosovës.

Gjatë vitit kam qenë anëtar i disa komisioneve:

1. Komisioni i Riintegrimit,
2. Komisioni për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore,
3. Komisioni ad hoc për vlerësimin e rrezikut për siguri njerëzore dhe materiale,
4. Komisioni i i Pranimeve
5. Komisioni për Identifikimin dhe verifikimin e punëve të përfunduara në projektin "Mirëmbajtja e Rrugëve lokale në Komunën së Dragashit për periudën verore 2019."

Gjatë gjithë vitit kemi pasur 13 kërkesa nga qytetarë dhe persona juridikë që të dalim në vend për të pastruar rrugën ose për të vlerësuar dëmet e shkaktuara nga rrëshqitjet e tokës, zjarret dhe të ngjashme. Nga këto, 12 kërkesa u përgjigjën nga komisioni i vlerësimit të dëmit, i cili ishte në vend dhe u raportoi për secilën pretendim të dëmit dhe bëri vlerësimin në të gjitha vendet ku ishte e mundur të vlerësohej.
Secila palë që paraqiti kërkesë në Zyrën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike ose Komisionin e Vlerësimit të Dëmit, pranoi siç duhet përgjigje, si dhe raport të vlerësimit të dëmit nëse ka ndodhur ndonjë dëm.

Me kërkesë të Drejtorit, kam kryer një vizitë inspektimi në të gjitha rrugët lokale në të gjitha fshatrat Gorës dhe Opojës së bashku me territorin e qytezës së Dragashit, me qëllim vlerësimin e gjendjes së rrugëve lokale, si dhe mirëmbajtjen e tyre verore.
Si anëtar i komisionit për vërtetimin dhe verifikimin e punimeve të realizuara për projektin "Mirëmbajtja e rrugëve lokale në territorin e komunës së Dragasit në periudhën e verës së vitit 2019" vërtetuam dhe përcaktuam vendet ku duhet të hiqet asfalti i vjetër dhe të shtohet i ri.

Po ashtu, si anëtar i Komisionit Ad Hoc për Vlerësimin e Riskut të Sigurisë së Njerëzve dhe Sigurisë Materiale, kemi dalur në vend të ngjarjës në fshatin Krushevë, si dhe në fshatin Restelicë ku kemi konstatuar faktet me procesverbal të rregullt të situatës, si dhe rekomanduam se si të hiqet rreziku për sigurinë e njerëzve dhe të mirave materiale.

Gjatë punës sime, vazhdoj të bashkëpunoj me të gjithë të punësuarit në drejtorinë tonë dhe shërbimet që i përkasin drejtoratit tonë dhe të cilat ofrojnë shërbime publike në mënyrë që të përmirësojnë performancën e përgjithshme dhe të ofrojnë një shërbim të plotë dhe cilësor.

Dragash, Dhjetor 2019.

Zyrtar për Shërbime Publike: Redzep Ibraimi

**RAPORT**

**Zyrtar i ndërlidhjes**

Në bazë të përshkrimit të punës dhe detyrave të punëtorit të ndërlidhjes si dhe nevojes se drejtoriatit për Mbrojtje shpetim dhe shërbime publike punët e mija i kam kryar me nder dhe ndërmar me prioritet dhe lehtësimin e dëmeve të shkaktuara në njerëz, pronë ose mejdis dhe të mirat materiale, si dhe me situatat të cilat është ballafaque këtë vit ky drejtoriat.

Po një ashtu kamë mbajt lidhjen telefonike mobile me qytetarët si pas nevojes që kan patur ata në lidhje me zjarret dhe reshjet e shiut gjatë sezonit të verës.

Gjatë periudhës janar – shtator kamë qenë anëtar i komisionit për vlerësimin e damëve të shkaktuara nga të reshurat e borës dhe shirave të rrembyara gjatë stinës së pranverës dhe verës.

Deri më tani kemi patur mbi dhjetë raste në disa fshatëra të rrënimit të kulmave të shtëpive dhe shtallave nga bora dhe shirat e rrëmbyra. Dhe një rast nga reshjet e shiut të cilit ka ndodhur uji i shiut i ka hyr në dhomat e banimit dhe ja ka prishur shtrojen dhe orindit.

Kurse gjatë muajit gusht – shtatot kemi lëshuar edhe tri vërtetime për qytetarët të cilit nuk kanë regulluar obligimin ushtarak, që nga viti 1999 me arsyetim që në Kosovë është KFOR-i.

Gjatë muajve shtator, tetor, nëndor dhe dhjetor kemi vazhduar me obligimet dhe detyrat që kemi pasur me plan program.

Kemi pas edhe dy kërkesa nga fshati Kuk që ka ndodhur zjarri dhe është djegur një shtallë dhe disa mjete teknike të pronarit Meriton Hasanit .Edhe Femi dhe Fadil Hasipi nga fshati KUK këta dy vëllazër kanë paraqityr kërkesë për vlersiminë e damëve të shkaktuara nga zjarri në shtëpit tyre.

Prej të gjitha këtyre kërkesave ka mbetur vetëm një pa realizue e Murtezan Shato nga fshati Restelicë.

Dragash, Dhjetor 2019.

Zyrtar i ndërlidhjes: Haki Hamdi

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosovo/Republic of Kosovo**
**Kuvendi Komunal Dragash/ Skupština Opštine**
**Dragaš/Dragas Municipality**
**Drejtorija për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike**
**Direktorijat za Odbranu, Spašavanje i Javne Usluge**

Raporti për mbeturina 2019

Gjatë vitit 2019 kemi pasur angazhime te bollshme duke filluar takimet e reja qe kemi pasur ne bashkpunim me asosacionin e komunave si dhe organizaten gjermane GIZ.

Me kete organizat takohemi me gjith koleget e krejt komunave te Kosovës ku diskutojmë ne lidhje me menyren per ndalim reduktim te mbeturinave te gjitha llojeve kemi pasur shumë takime si dhe kemi udhtuar disa vende per ti parë nga afer disa puntori qe mirren me asgjesimin e mbeturinave , disa raste studimore perpos Kosovës kemi qenë edhe Maqedoni ,si dhe Mal te Zi ne menyrë qe te perfitojmë ideja se si duhet marrur me mbeturina.

Kemi fituar nje projekt ne bashkpunim me ministrinë e mjedisit per rregullimin e mirmbajtjen e deponisë si dhe largimin e njefar uji dhe pregaditjen e pastrimit diku ne vlerë prej 25.000 euro ne 2018 por do vazhdojm perfitimin e 50.000 eurove tani ne vitin 2019, si dhe i kemi afruar bashkpunimin me kompaninë pergjese „EKO REGJIONI".

Në menyrë te veqant do ju dergojë raportin I vjeqarë të kompanisë .

Jemi duke vazhduar bashkpunmin me GIZ dhe Asosacionin e Komunave si dhe kemi aplikuar me nje plan tek organizata pergjegjse Japoneze JICA në menyrë qe ata te na ndimojnë ne lidhje me zgjerimin e kompanisë si dhe furnizim me mjete per kompaninë si dhe shumë benifite tjera .

Kemi dalur ne teren me Dejtorin se bashku per te pare nga afer problemet me qytetarë ne lidhje me mbeturinat si dhe kemi diskutuar per ta vazhduar angazhimin ne lidhje me eliminimin e tyre.

Shpresojmë qe ky fundvit 2019 si dhe vitin 2020 te realizohen kerkesat tona si dhe te perfitojmë benifite te lartcekura ne menyrë ti letsojmë jeten e qytetarit dhe ta zbutim kreaturen e mbeturinave.

Perpos rregullores qe kemi realizuar ne 2016 tani se bashku me kompanin kemi filluar te mirremi dhe jemi duke pregaditur planin 5 vjeqar qe planifikojm te pefundojm dhe ta bojm valid nga 2020 deri ne vitin 2025 shpresojm me ndimen e Kryetarit dhe Asambles Komunale.

Presim nga ky fundvit si dhe fillimi i 2020 bashkpunim me te lart me organizaten Japoneze JICA ,siq na ka premtuar ne menyrë ta letsojm sherbimin e qytetarit duke na furnizuar me mjete kompaninë pergjegjse si dhe te na ndimon me kshilla mua si zyrtar dhe kopaninë pergjegjse se si duhet punuar pasi ata kan shembuj dhe jan nje nga ma te mirit ne Botë për kete qeshtje.

Kamë kerkuar nga pergjegjsi i kompanisë „EKO REGJIONI“ qe te jenë sa me korrekt me punen ne vazhdim ne menyrë qe ta bejnë sa ma te letsushme sherbimin e qytetarit dhe inkasimi te jetë sa me ne nivel si dhe duke marr parasysh qe te futen ne sistem disa fshatra qe nuk jan ne sistem si dhe te sherbehen mire qe mos kete pa kenaqsi, ne menyre qe te dy palet te mbetemi te knaqur.

Me ndihmen e Kryetarit i kemi nda se paku 50.000 mijë euro për ti asgjesuar deponitë e ngurta ilegale ne komunen tonë, ku si rrjedhojë është hapur tenderi dhe firma ka qene korrete ne realizimin e ketij projekti dhe ka asgjesuar bukur disa deponi te ngurta ilegale, si rrjedhoj do dergojmë edhe raportin e fotografitë pasi ti marrim nga komisioni pergjegjsë.

Krejt ne fund shpresoj te vazhdojmë me pune ti arrijmë qellimet se bashku qe te jemi sa me te knaqur ne si istutucion kompoania e sherbimi ndaj konsumatorit te jet ne nivel te duhur.

Zyrtarë për Mbeturina:

Bashkim Emini

PLANI I PUNËS I DREJTORATIT PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE SHËRBIME PUBLIKE

PËR VITIN 2020

Duke ju referuar përgjegjësive të Drejtorisë, fushëveprimin e nenit 67 të Statutit të Komunës së Dragashit, si dhe përvojën e fituar nga terreni, Drejtoria në vitin 2020 parashikon Planin e ardhshëm të punës, me të cilin do t'i përgjigjet kërkesave dhe sfidave në vitin e ardhshëm.

| Nr. | Përgjegjësit | Aktivitetet | Koha e realizimeve sipas tremujorve | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Shërbimet emergjente dhe zjarrfikëse | 1. Forcimi i kapacitetit të njësisë së zjarrfikësve, e cila funksionon brenda Drejtorisë, në kuptim të Planit të Trajnimit të përshkruar nga AME / MPB për vitin 2020. | X | X | X | X |
| | | 2. Përmirësimi i kushteve të punës, pajisjeve dhe automjeteve për t'u përgatitur plotësisht për veprime në kohë dhe të suksesshme të shuarjes së zjarreve dhe rreziqeve të tjera shoqëruese për qytetarët dhe të mirat publike. | X | X | X | X |
| | | 3. Marrja e masave konkrete për të parandaluar rrezikun dhe mbrojtjen e qytetarëve dhe të pasurive. | X | X | X | X |
| 2. | Vlerësimi, njoftimi dhe alarmimi i popullatës në rast të kërcënimeve dhe rreziqeve, organizimi dhe mirëmbajtja për alarmim në një sistem unik alarmi, si dhe funksionimi i lidhjeve për mbrojtje, shpëtim dhe ndihmë në përputhje me një sistem unik lidhjesh | 1. Duke qenë se zyra ndërlidhëse afër drejtoratit qe një kohë të gjatë nuk është në kapacitet të plotë për vitin 2020, do të përpiqemi të përmirsojm gjendjen në sektorin e komunikimit, duke pasur parasysh rrethanat. | X | X | X | X |
| | | 2. Përditësimi i të dhënave, të fatkeqësive natyrore dhe elementare në tërë territorin e komunës | X | X | | |
| | | 3. Komunikimi me shërbimet relevante në kuptimin e koordinimit të punëve dhe aktiviteteve, ndihmë reciproke me qëllim të realizimit të qëllimeve të përcaktuara. (CPMedicine, Policia, FSK, KFOR, Kryqi i Kuq, Shkollat, AME, Shërbimi Gjeologjik i Kosovës etj). | X | X | X | X |
| 3. | Planifikimi dhe realizimi i masave mbrojtëse për mbrojtje dhe shpëtim, si dhe vlerësimi i rrezikut dhe zhvillimi i planeve për fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera. | 1. Në bashkëpunim me drejtoratin e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është i mundur harmonizimi i planeve për ndërtimin e mureve mbështetëse nga shembjet dhe muret mbrojtëse nga përmbytjet, në mënyrë që të sigurohen shtretërit e lumenjve në vendet kritike, si dhe marrja e masave siguruese në rrugën Krushev-Globoçicë. | X | X | X | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Përditësimi i Vlerësimit të rrezikut duke paraqitur propozim KK për marrje të vendimeve, në bazë të rekomandimeve nga raporti i Shërbimit Gjeologjik të Kosovës, si dhe informatat nga ana e qytetarëve të Zlipotokut për lëvizje të tokës në drejtim të "Boriste – Shkolla e Vjetër" | | X | X | |
| | | 3. Në bazë të mundësive duhet të angazhohet (punësohet) bashkëpunëtor profesional për planifikim dhe menaxhim me situatat emergjente. | | | | |
| **4.** | Propozimi për themelimin e Komitetit të mbrojtjes dhe shpëtimit nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë tjera, organizimi i komiteteve, njësive dhe shërbime për forcat e mbrojtjes, shpëtimit dhe ndihmës. | 1. Drejtorati do të propozojë themelimin e komitetit të mbrojtjes dhe shpëtimit për arsye të nevojës së krijimit dhe koordinimit të ekipit për rastet emergjente. Është paraparë që për tërë vitin 2020, për shkak të peridhës kohore, si dhe kushteve tjera që nuk varen nga Drejtorati jonë që ky aktivitet i planifikuar të realizohet. | X | X | X | X |
| **5.** | Bashkëpunimi me komunat fqinje për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera | 1. Komunikimi me drejtoratin e komunës së Prizrenit dhe takimet e mundshme rreth marrveshjes së shërbimeve rreth veprimtarisë të përbashkët në situatat e jashtëzakoshme dhe ofrimin e ndihmës së ndërsjelltë. | X | X | X | X |
| **6.** | Ofrimi i shërbimeve publike dhe infrastrukturore duke përfshirë transportin lokal, mirëmbajtjen e rrugëve, furnizimin me ujë, furnizimin me ujë, kanalizimet, menaxhimin e mbeturinave | 1. Vazhdimi i bashkëpunimit me Keds-in | X | X | X | X |
| | | 2. Kompania për mirëmbajtje të rrugëve dimërore dhe verore "Drini Kompani" në bazë të marrveshjes së nënshkruar, | X | X | X | X |
| | | 3. “Hidroregjioni” rreth furnizimit me ujë dhe kanalizimit të Dragashit, | X | X | X | X |
| | | 4. “Ekoregjioni” përmirësimi i shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave si dhe kyçja e fshatërave të tjera në sistemin e grumbullimit të mbeturinave, si dhe aktivitet tjera. | X | X | X | X |
| | | 5. Vazhdimi i aksionit të trajtimit të qenëve endacak varësisht nga nevoja. | | X | X | |

Dragash më: 10.01.2020

Drejtori: Murselj Haljilji

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova/Republic of Kosovo**
**Komuna Dragash/ Opština Dragaš/Dragas Municipality**

# R A P O R T

**I PUNËS SË DREJTORATIT TË ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT,**
**për vitin 2019 & Planin e Punës, për vitin 2020**

**Drejtori: Eroll Bajrami**

**Dragash,________2020**

# Drejtoria për Administratë të Përgjithshme

Raporti vjetorë i hartuar nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme ka për qëllim që të pasqyrojë aktivitetet dhe punën që është zhvilluar gjatë vitit 2019 në sektorët që i përkasin kësaj Drejtorie si dhe informimin e drejtë të qytetarëve, institucioneve komunale, shoqërive civile dhe të gjitha palëve që janë të interesuara për punën e kryer gjatë këtij viti.

Drejtoria e administratës është orientuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore, duke patur parasysh se shërbimet krijojnë lidhjen e Pushtetit Lokal dhe të qytetarëve si dhe njëkohësisht, Pushteti Lokal ruan lidhjet edhe me Pushtetin Qëndrorë.

Kjo dretori ka bërë ushtrimin dhe zbatimin e shërbimeve të përgjithshme administrative për organet administrative dhe organet tjera komunale dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët e Komunës së Dragashit, në kuadër të kompetencave vetanake apo të deleguara ligjore gjatë vitit 2019. Shërbimet janë produkte të cilat komuna u ofron qytetarëve të sajë në bazë të nevojave dhe kërkesave të vlerësuara dhe të sanksionuara me akte administrative dhe ligjore.

Drejtoria për Administratë të Përgjithshme punën e saj e bazon brenda kornizave ligjore të cilat janë në fuqi: Ligji për vetëqeverisjen lokale, Ligji mbi Shërbimin Civil, Ligjin mbi Librat Amzë, Statutin e Komunës, Rregulloret komunale, Urdhëresat dhe Udhëzimet, si dhe është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve për qytetarë.

Drejtoria për Administratë të përgjithshme është kujdesur gjatë vitit 2019 që të krijojë kushte më të përshtatshme të punës për zyrtarët në mënyrë që shërbimet të jenë në nivel të kënaqur për qytetarët e Komunës së Dragashit

Nga buxheti i drejtorisë për administratë të përgjithshme ashtu siç janë planifikuar mjetet edhe kemi arritur ti realizojmë qëllimet duke mbuluar: Pagat për stafin që i përkasin Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, gjithashtu janë paguar edhe shërbime të ndryshme nga ky buxhet sipas planifikimeve buxhetore këtu përfshihet, shërbimi i telefonisë mobile, vizita studimore, shpenzime postare, inventar për nevojat e të gjitha zyreve në kuadër të Komunës së Dragashit, furnizimi me Lap Top për nevojat e antarëve të Kuvendit Komunal etj, të gjitha shpenzimet e Drejtorisë për Adminstratë të përgjithshme janë të paraqitura edhe në raportet financiare.

Drejtorati i Administratës së Përgjithshme në aspektin orkanizativ ndahet në disa sektorë që do të paraqiten si në vijim,

I. **SEKTORI I GJENDJES CIVILE (OFIQARIA);**

II. **ZYRA PËR SHËRBIME TË QYTETARËVE DHE ARKIVI;**

III. **ZYRA E PROKURIMIT;**

IV. **SHËRBIMET TEKNIKE;**

V. **NJËSIA PËR IT.**

# I. Sektori i Gjendjes Civile (Ofiqaria)

Shërbimi i Gjendjes Civile në Komunën e Dragashit gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2019 ka arritur që të jetë shumë efikas dhe ti shërbejë të gjithë qytetarët në kohë optimale. Gjatë kësaj periudhe ky shërbim në kuadër të kompetencave të saja kryen një sërë aktivitetesh ku do ti paraqesim në vazhdim të këtij raporti.

Me punën e zyrtarëve të Gjendjes Civile arrihet që të lëshohen një numër i konsiderueshëm i dokumenteve nga ky sektor ku varion nga 30,000-35,000 brenda një viti. Kjo tregon që shërbimi për marrjen e një dokumenti të nevojshëm është shumë i shpejtë, efikas, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm me kapacitetet e saja aktuale që ka. Është bërë progres pozitiv pas përmirësimit të kushteve të punës dhe furnizimit kronologjik me legjislacion nga ARC-MPB.

Shërbimi i Gjendjes Civile (Ofiqaria) është i organizuar në pesë lokacione të cilat gjenden si në vijim:

- Dragash,
- Bresanë,
- Llapushnik,
- Krushevë dhe
- Brod.

Këto pesë lokacione janë të vendosura në këtë mënyrë me qëllim që qytetarët ti kenë sa më afër Shërbimet e Gjendjes Civile ku mbulohet i gjithë territori i Komunës sonë.

Gjatë sezonit veror ku edhe fluksi i qytetarëve është më i madh se zakonisht me vendim të Kryetarit të Komunës kemi bërë zgjatjen e orarit të punës nga data 18.07.2019 deri me datë 18.08.2019 nga ora 7:30 deri në ora 17:30 e gjithë kjo vetëm e vetëm që qytetarët e komunës sonë ti kryejnë shërbimet sa më shpejtë të jetë e mundur. Pra orari është zgjatur për periudhë kohore 1 mujore ku edhe gjatë këtij muaji dihet se ka fluks më të madh të njerëzve.

Drejtoria për Administratë të përgjithshme është kujdesur që të përmirësoj kushtet e punës për të gjitha zyrat e vendit duke u bazuar në kërkesat e stafit të sajë në mënyrë që të rritet efikasiteti në punë, në vazhdim do ti cekim disa nga punët që kemi kryer gjatë kësaj periudhe kohore.

**Zyra e vendit në Bresanë:** Pasi që gjatë vitit 2018 kemi ndërruar lokacionin e kësaj zyreje na është dashur që të kryejmë edhe disa investimi shtesë në mënyrë që të përshtatim kushtet e punës sipas standardeve të këruara. Në këtë investim janë përfshirë: Ndërtimi i oxhakut, ngjyrosja e mureve, montimi i konstruksionit të amstrongut në mënyrë që të përshtatet lartësia optimale për punë, montimi i konstruksionit metalik në pjesë e jashtme të dyerve dhe dritareve të zyrës së vendit në mënyrë që të bëhet sigurimi më i mirë i objektit, janë riparuar dhe zëvendësuar trupat ndriques – prizave dhe ndërprersave si dhe është bërë furnizimi dhe montimi i kamerave të sigurisë me të gjitha pjesët përcjellëse.

**Zyra e vendit në Krushevë:** Kjo zyrë gjatë këtij viti më konkretisht me datë 10.06.2019, ka pësuar incident ku është kapluar nga zjarri dhe është shkatrruar pothuajse i gjithë objekti në të cilin kjo zyre i kryente shërbimet ku dhe kemi pranuar raportin e policisë, më pas e kemi zhvendosur këtë zyre në një objekt tjetër që është në afërsi me objektin ku punohej në të kaluarën.

Pasi që na është dashur që të ndërrojmë lokacionin e objektit rrjedhimisht është paraqitur nevoja që të plotësojmë kushtet e punës në këtë zyrë sipas standardeve të kërkuara, investimi në këtë zyrë përfshinë: montimi i konstruksionit metalik në pjesë e jashtme të dyerve dhe dritareve të zyrës së vendit në mënyrë që të bëhet sigurimi më i mirë i objektit, furnizimi dhe montimi i kamerave të sigurisë me të gjitha pjesët përcjellëse të sajë.

**Zyra e vendit në Llapushnikë:** Në këtë zyre kemi bërë gjithashtu disa investime për të përmirësuar kushtet e punës, në investim përfshihet: Muratimi i blloqeve nga siporeksi i mureve të kësaj zyreje, suvatimi dhe gëlqerosja, montimi i laminatit në dysheme, punimi i pllakave keramike të dyshemesë dhe mureve të tualetit, furnizimi dhe montimi i derës së brendshme të tualetit, rregullimi i kushteve të tualetit përfshi këtu nyjet e sanitarisë, lavamanin, bojlerin etj, riparimi dhe zëvendësimi i trupave ndriques, vendosja e kamerave të sigurisë me të gjitha pjesët përcjellëse, ngjyrosja e plafonit dhe mureve të brendëshme, montimi i konstruksionit metalik në pjesë e jashtme të dyerve dhe dritareve të zyrës së vendit në mënyrë që të bëhet sigurimi më i mirë i objektit.

**Zyra e vendit në Brod:** Gjithashtu edhe në këtë zyre kemi përfunduar punimet nga investimet që janë paraparë, në këtë investim janë planifikuar sipas projektit punët që do ti cekim në vazhdim: Punimi i trotuarit përgjatë perimetrit të objektit, punimi i shkallëve të jashtme hyrëse, muratimi i oxhaqeve egzistuese mbi sipërfaqen e pllakës, ngjyrosja e mureve dhe plafonëve, pastrimi dhe meremetimi i fasadës ku ka qenë e dëmtuar, montimi i konstruksionit metalik në pjesë e jashtme të dyerve dhe dritareve të zyrës së vendit në mënyrë që të bëhet sigurimi më i mirë i objektit, montimi i kamerave të sigurisë dhe drenazhimi i objektit.

Më poshtë do ta paraqesim në mënyrë tabelare punën e Sh.Gj.C.-së ku shihet se ky shërbim është mjaft efikas ku ka arritë të lëshojë **38,026** dokumente të ndryshme, në krahasim me vitin paraprak

që janë lëshuar **38,023** dokumente, përafërsisht ka qenë numri i njejtë i certifikatave të lëshuara gjatë këtij viti dhe vitit të kaluar.

1. Në vitin 2019 janë lëshuar këto Çertifikata:

| Nr. Rend. | Lloji i certifikatës | Numri për njësi **2017** | Numri për njësi **2018** | Numri për njësi **2019** |
|---|---|---|---|---|
| 1. | Çertifikata të Lindjes | 6,793 | 6,960 | 7,212 |
| 2. | Çertifikata të Martesës | 4,018 | 4,371 | 4,483 |
| 3. | Çertifikata të Vdekjes | 1,111 | 1,540 | 1,552 |
| 4. | Çertifikata të Shtetësisë | 559 | 569 | 576 |
| 5. | Çertifikata të Statusit Martesore | 727 | 668 | 759 |
| 6. | Ekstrakte të Lindjes | 17,248 | 20,404 | 20,199 |
| 7. | Dekleratë të Bashkësisë Familjare | 1,508 | 1,580 | 1,655 |
| 8. | Çertifikata të Vendbanimit | 131 | 778 | 1,147 |
| 9. | Vërtetim nga Arkiva | 500 | 1,021 | 321 |
| 10. | Aktvdekje | 134 | 132 | 122 |
| **GJITHSEJTË:** | | **32,729** | **38,023** | **38,026** |

2. Regjistrimet në librat amzë:

| Nr. Rend. | Emri i akteve | Viti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **2017** | **2018** | **2019** |
| 1. | Në Aktet e Lindjes | 65 | 42 | 22 |
| 2. | Në Aktet e Martesës | 300 | 254 | 102 |
| 3. | Në Aktet të Vdekjes | 139 | 186 | 53 |
| **GJITHSEJTË:** | | **504** | **482** | **177** |

3. Regjistrimet në Librat Amzë për të Lindurit, Martesat e Lidhura dhe Vdektjet në Botën e Jashtme:

| Nr. Rend. | Emri i akteve | Viti | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **2017** | **2018** | **2019** |
| 1. | Në Aktet e Lindjes | 446 | 456 | 184 |
| 2. | Në Aktet e Martesës | 109 | 121 | 89 |
| 3. | Në Aktet të Vdekjes | 162 | 166 | 82 |
| **GJITHSEJTË:** | | **527** | **743** | **355** |

Shërbimi i Gjendjes Civile gjithashtu në bazë të **nenit 31 të Ligjit për Shtetësi**

Ka regjisturar: 26 qytetarë

Për lirim nga shtetësia e Republikës së Kosovës kanë aplikuar: 80 qytetarë

Për fitim të shtetësisë kanë aplikuar: 37 qytetarë

## II. Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

Zyra për shërbim të Qytetarëve u shërben qytetarëve për t'u informuar me procedurat e nevojshme për kryerjen e punëve administrative në harmoni me dispozitat pozitive për kryerjen e shërbimeve të ndryshme nga organet e administratës komunale. Zhvillimi i procedurave bëhet si në vijim: fillimisht paraqitet kërkesa, protokolohet, skenohet, ruhet në softver pastaj shpërndahet me anë të librave të brendshëm dhe elektronikë deri tek drejtoratet përkatëse nga ana e personit të autorizuar për kryerjen e këtij shërbimi. Protokoli për këtë procedurë administrative mbahet në mënyrë elektronike si dhe me shkrim, njëherit të gjitha kërkesat, dokumentet dhe shkresat të cilat janë të protokoluara, skenohen dhe më pas përcillen në ministri dhe në drejtori përkatëse me anë të sistemit të intranetit. Kështu në çdo moment mund të përcjellim në këtë sistem azhurimet e shërbimeve përbrenda komunës. Gjatë vitit 2019 në këtë zyrë janë regjistruar gjithsejt **7225** lëdnë.

Në këtë zyre gjithashtu kryhen edhe pagesat e shërbimeve komunale sipas Rregullores mbi Taksat Komunale për shërbime të caktuara. Gjatë vitit 2018 janë inkasuar gjithsejt **12,473 €**, ndërkaq në vitin 2017 jane grumbulluar **21,829€**. Vërehet një rënje e të hyrave nga pagesat e shërbimeve në këtë zyrë pasi që Zyra e Gjendjes Civile ka kaluar në objektin tjetër dhe pagesat për dokumentet e Gjendjes Civile bëhen nga vetë zyrtarët.

## III. Zyra e Prokurimit

Zyra e Prokurimit funksionon në përputhje me Ligjin e Prokurimit Publik të Republikës së Kosovës dhe akteve të tjera që janë nxjerrë nga ky Ligj,

Kjo zyrë gjatë vitit 2019 ka qenë mjaftë efikase ku ka arritur që të kryej punët e saja me një dinamikë të madhe duke arritur që të realizojë me sukses buxhetin e planifikuar për këtë vit, duke përfshirë projektet e investimeve kapitale, projektet për blerjen e mallrave dhe shërbimeve si dhe për nevoja të tjera të të gjitha sektorëve të Komunës së Dragashit ku në vazhdim do të paraqesim punët që ka kryer kjo zyrë duke pasur bashkëpunim të ngushtë me të gjitha drejtoratet përkatëse në mënyrë që të realizohen të gjitha objektivat e parapara për këtë vit.

Duke llogaritur numrin e aktiviteteve të prokurimit mund të shohim se ka pasur një numër të konsiderushëm të tyre numri i të cilave është 181 aktivitete gjatë këtij viti, pagesat që janë bërë për operatorët ekonomikë të cilët kanë qenë të kontraktuara nga Komuna e Dragashit për realizimin e projekteve dhe blerjeve të planifikuara ku vlera totale ka arritur **2,069,841.18€**

Kjo vlerë e paraqitur në këtë raport është realizur me një numër të madh operatorësh ekonomik, numri i përgjitshëm i të cilëve ka arritur rreth 80 prej tyre, ku vërehet se është rritur interesimi i operatorëve ekonomik të cilët dëshirojnë që të angazhohen për të aplikuar me ofertat e tyre në projektet e Komunës së Dragashit.

Të gjitha kontratat e nënshkruara me operatorët ekonomikë mund ti gjeni në web faqen e Komunës së Dragashit të publikuara për secilën veq e veq ku të gjithë qytetarët apo grupet e ndryshme të interesuara për punën që ka bërë kjo zyrë kanë qasje dhe mund të kyqen online për të parë punët që janë kryer.

## IV. Shërbimet Teknike

Në kuadër të këtij shërbimi janë të përfshirë këto njësi

1. **Autoparku i Komunës**
2. **Rojet e objekteve Komunale**
3. **Shërbimi i pastrimit të objekteve Komunale**

**Autoparku:**

Ky shërbim gjatë vitit 2019 ka qenë i organizuar me katër punonjës të stafit teknik të angazhuar, dy nga nënpunësit janë vozitës të autobusëve të komunës dhe dy të tjerë vozitës të veturave të Administratës. Kështu që gjatë këtij viti kanë funksionuar dy autobusë për bartjen e nxënësve të shkollave të mesme të ulëta si dhe plotësimi i nevojave të ndryshme të paraqituara kohë pas kohe sipas kërkesave specifike të shkollave, të klubeve të futbollit dhe shoqerisë civile, ndërsa veturat zyrtare të komunës janë shfrytëzuar nga zyrtarët komunal të cilët për nevoja të komunës kanë udhëtuar sikur brenda regjionit ashtu edhe jashtë regjionit varësisht nga ftesat apo punët zyrtare që janë paraqitur nga zyrtarët e drejtorive të ndryshme.

Zyrtarët e autoparkut të komunës janë kujdesur për evitimin e problemeve të ndryshme të veturave dhe autobusëve zyrtarë të komunës ku janë angazhuar për ta bërë servisimin e rregullt të tyre, sigurimin dhe regjistrimin e të gjitha automjeteve zyrtare në kohë në mënyrë që automjetet të jenë sa më funksionale dhe në gjendje gatishmërie për ti arritur objektivat jasht institucioneve komunale.

Gjatë këtij viti kemi realizuar blerjen e tri (3) veturave të reja ku njëra do të përdoret për nevojat e Kryetarit të Komunës dhe dy të tjera për nevojat e Administratës Komunale.

**Sigurimi i Objekteve Komunale:** Ky shërbim kujdeset për sigurinë e objekteve komunale gjatë natës ku është i organizuar me tre puntorë të cilët janë përgjegjës për sigurinë nga rreziqet e ndryshme që mund të paraqiten në objektin e Komunës së Dragashit dhe objektin e DKA-së. Gjatë këtij viti nuk kemi patur kurrfar vështërsish rreth mirmbajtjes dhe ruajtjes së objekteve Komunale.

**Pastruesit e objektit:** Ky shërbim është përgjegjës për mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të komunës, duke përfshirë të gjitha zyret dhe hapsirat që janë brenda objektit të Komunës dhe të gjitha hapsirat që janë në objektin e DKA-së sajë, gjithashtu duhet të raportojnë për problemet eventuale që mund të paraqiten gajtë punës apo mungesës të mjeteve të punës ku kërkesat e tyre paraqiten në Drejtorinë e Administratës në mënyrë që shërbimi të përmirësohet, momentalisht në këtë shërbim punën e bëjnë vetëm tre persona.

## V. Njësia e Teknologjisë Informative

Njësia për Teknologji Informative është zyrë shumë dinamike dhe konsiderohet si kyçe në punët Administrativo-teknike. Kjo zyrë e ka këtë rëndësi për shkak të vizionit dhe realizimit të përditshëm të një qeverisje elektronike, duke u kujdesur që planet të realizohen në vepra me përdorim të teknologjisë moderne.

Kjo zyrë gjatë kësaj periudhe ka zhvilluar këto aktivitete:

- Intervenime rutinore nëpër kompjuterë të punëtorëve të administratës komunale të cilat kanë pasur nevojë për ruajtjen e shënimeve, formatizimin e tzre, intervenime softuerike, etj.
- Mirëmbajtjen e sistemit të intranetit.
- Mirëmbajtja e sistemit elektronik të arkivimit.
- Mirmajtja e sistemit të e-pasuris
- Kontrollimi dhe mirëmbajtja e përditshme të serverëve.
- Puna e përditshme në Ueb faqen e Komunës,
- Mirëmbajtja e llogarive të emailave zyrtarë
- Krijimin e shfrytëzuesve të ndryshëm në sistemin e intranetit dhe në domenin qeveritar
- Janë kryer punët e ndryshme sipas kërkesave në fushën e teknologjisë informative
- Takime të ndryshme me ftesë nga Ministria
- Përkrahja në mbajtjen e mbledhjeve të asamblesë komunale, lidhja direkte në kanalin e youtube, dhe plasimi i inqizimeve ne ueb faqen e komunës.
- Intervenime në teren, nëpër zyret e gjendjes civile, etj.

# PLANI I PUNËS

# 2020

## Sektori i Gjendjes Civile

- Dhënja e informatave dhe informimi korrektë i qytetarëve për procedurat e regjistrimit të lindjeve, martesave dhe vdekjeve,
- Përpjekje që qytetarët të jeni të kënaqur me kohën e kryerjes së shërbimeve dhe ofrimin e shërbimeve më të mira,
- Lëshimi i dokumenteve të Gjendjes Civile në kohë optimale, duke zbatuar legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës,
- Përcjellja e punës dhe aktiviteteve të të gjithë zyrtarëve të sektorit të Gjendjes Civile duke kryer punët me efikasitet sa më të lartë dhe duke u munduar që të ju plotësohen edhe me tekë kushtet e punës sipas kërkesave që do të dalin gjatë punës,
- Bashkpunim i ngushtë me ministritë e linjës si MPB, MAPL, MAP si dhe departamentet që operojnë në kuadër të këtyre ministrive duke e cekur DRGJC-ARC që janë në kuadër të MPB si dhe bashkpinimin me sektorët e teknologjisë informative të cilët përcjellin programet e punës dhe veprimtarive të Gj.C.
- Raportimi nga Sektori i Gjendjes Civile në periudha të rregullta me të dhënat që do ta përfshijnë punën e këtij sektori si dhe raportimi i rregullt i Entit Statistikorë të Kosovës.
- Zbatimi i ligjeve dhe akteve nën – ligjore të reja apo të ndryshuara dhe përcjellja me kohë te vartësit e Sektorit të Gjendjes Civile.

## Zyra për Shërbime të Qytetarëve dhe Arkivi

Planifikimi i objektivave dhe punëve që do të ketë kjo zyrë gjatë vitit të ardhshëm janë si në vazhdim:

- Qendra për shërbimin e qytetarëve do të funksionon si pjesë e strukturës organizative të administratës së komunës.
- Çdo shërbim publik që ofron komuna, duhet të protokollohet përmes qendrës dhe secila drejtori duhet të jetë e lidhur me këtë qendër.
- Qendra do të pranon dhe procedon për shqyrtim dhe vendosje kërkesat e qytetarëve në drejtorit komunale dhe njësit organizative brenda drejtorive.
- Qendra ofron shërbime tjera si vijon: shërbimet e arkivës, shërbimet e gjendjes civile, tatimin në pronë, shërbimet kadastrale dhe të gjitha shërbimet tjera
- Qendra duhet të këshillojë dhe të ndihmojë në qështjet teknike administrative për mënyrën e plotësimit të kërkesave
- Do të bëjë pranimin dhe regjistrimin e kërkesave
- Do të bëjë mbajtjen e dosjeve, statistikave të kërkesave të paraqitura nga qytetarët
- Gjithashtu do të protokollojë të gjitha aktet e nxjerra nga organet e komunës;

## Zyra e Prokurimit Publik

Kjo zyre pos realizimit të buxhetit të aprovuar nga Asambleja Komunale për investime kapitale dhe shpenzime të ndryshme që ka komuna.

Në mënyrë që projektet të realizohen me sukses për ta arritur një përqindje të konsiderueshme të realizimit të buxhetit që është paraparë për vitin 2020, zyra e Prokurimit do të bashkëpunoj sa më tepër me të gjitha drejtoritë si në projektet e investimeve kapitale poashtu edhe me furnizimet e nevojshme për organet e administratës komunale.

## Shërbimet Teknike

### Njësia e Autoparkut Komunal:

Sa i përketë Shërbimeve Teknike të njësisë së autoparkut të komunës është planifikuar që:

- Të gjithë përdoruesit e automjeteve duhet që të përdorin automjetet zyrtare në mënyrë sa më ekonomike dhe efikase
- Do të bëhet vendosja e sistemit të GPS tek të gjitha automjetet zyrtare që janë në përdorim
- Do të bëhet vendosja e simboleve apo shenjave të Komunës së Dragashit tek automjetet zyrtare
- Do të bëhet servisimi i rregullt i automjeteve në mënyrë që automjetet të jenë vazhdimisht në dispozicion për kryerjen e detzrave zyrtare

## Njësia e Teknologjisë Informative

Objektivat apo planet e njësisë së IT për vitin 2020 janë disa që do ti paraqesim si në vijim:

Sfidë mbetet infrastruktura e dobët e rrjetit, dhe mungesa e mjeteve financiare për përmirësimin e kësaj infrastrukture, cila po na shkakton problem, mirpo sipas mundësive buxhetore planifikojmë që këtë problem ta evitojmë.

Gjat vitit 2020 planifikojmë që të përmirësojmë infrastrukturën e brendshme, gjithashtu investime ne pajisje të teknologjisë informative nëpër kompjuterët të cilat kanë performanca më të dobët, pasi që dihet se kompania Microsoft ka ndërprere përkrahjen për sistemit operativ Windows 7, dhe të gjithë kompjuterët që kanë të instaluar këtë sistem operativ do të duhet të kalojnë në Windows 10. Për të kaluar në sistemin e ri do të duhet të bëhen investime neper kompjuter siç janë shtimi i ram memoris etj.

Drejtori i Drejtoratit për
Administratë të Përgjithshme

**Eroll Bajrami**